

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly of Rahovec

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 30.05.2018 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatoj se kuorum, përmbytjen e mbledhjes kemi, Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes Nënkyetarin e Komunës z. Fatmir Iska, përfaqësuesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, përfaqësuesit e mediave, Drejtoret e Drejtive Komunale, delegatët e Kuvendit Komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

RENDITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme në fshatin Ratkoc,
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm për Drejtorin për Punë Inspektuese,
6. Informatë rreth sigurisë në shkollat e Komunës së Rahovecit,
7. Informatë rreth ecurisë së hartimit të PZHK-së,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Stone Castle),
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Rahovec, parcelat 03709-0, 03710-0,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fshatin Çifllak, parcela 00217-1
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fshatin Çifllak, parcela 00217-2,
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Rahovec - Rimnik, parcelat 03818-0, 03870-0, 03871-0, 03819-0,
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Caktimin e Lokacionit për Vendosjen e Trafostacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale,
14. Marrja e Vendimit për formimin e Komisionit ad - hoc për zgjedhjen e Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendarë desha të ju njoftoj se nga vendimet që i kemi marrë në mbledhjen e kaluar, na janë kthyer të gjitha pozitive nga ana e MAPL-së. Po ashtu të nderuar për pikën e fundit të rendit të ditës së mbledhjes së sodit na ka ardhur një ankesë nga një qytetar nga Hoça e Madhe, i cili kërkon që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, po kjo ankesë nuk është e protokolluar dhe nuk ka dhënë kurrfarë sqarim se kënd e përfaqëson ky qytetar, prandaj mendoj se kjo kërkesë nuk është valide.

Trajko Shariq – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, desha të ju njoftoj se kjo ankesë është qëndrim i një personi, ky person nuk e përfaqëson askënd, prandaj shumë mirë e thatë se kjo ankesë nuk është valide. Propozimi im si anëtar i kuvendit që jam nga radhët e komunititetit pakicë serb, të vazhdohet me rendin e ditës duke përfshirë edhe këtë pikë.

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit, nëse jo e qes në votim Procesverbalin: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Florije Boshnjaku – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar i kam dy propozime tek kjo pikë dhe propozoj që këto propozime të hedhen në votim. Propozimi i parë është sa i përket çështjes së personave me astësi të kufizuar, që është një kategori e shoqërisë dhe ne e kemi për obligim që ti ndihmojmë, propozimi im është që të mbahet një takim me ekzekutivin dhe anëtarët e kuvendit, Hendikosin dhe OJQ-të e ndryshme, që ta përpilojmë strategjinë për personat me astësi të kufizuar. Besoj se pas kësaj strategjie do ta kemi edhe planin e veprimit, siç veprojnë edhe komunat e tjera, kërkoj përkrahje nga ana e kolegëve për këtë propozim. Propozimi i dytë është, ne e dimë të gjithë që i kemi këshillat lokalë dhe këta këshilla e kanë mandatin 4 vjeçar ashtu siç e kemi edhe ne kuvendarët, anëtarëve të këshillave ju ka kaluar afati, prandaj propozoj që të iniciohet kjo çështje dhe të formohen këshillat e ri lokal në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Rasim Fazliu – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, mendoj se kolegia shumë mirë i bëri propozimet, por sa i përket propozimit të dytë mendoj se është çështje e ekzekutivit dhe ju e dini më mirë se ne se kur i skadon afati dhe nuk kemi nevojë sot të diskutojmë për këtë dhe të marrim qëndrime të caktuara. Pastaj ju jeni ata që e propozoni si pikë të rendit të ditës, ku formohet komisioni dhe vazhdohen me procedurat e mëtutjeshme.

Nënkyetari – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, çështja qëndron se disa vendime për kryetar të fshatrave që janë marrë tanimë i ka skaduar mandati, kurse ka disa vendime që skadojnë në muajin korrik, prandaj mendoj se ne duhet që të presim që ti skadojë mandati të gjithë kryetarëve të fshatrave e pastaj të vazhdojmë me procedurat për formimin e komisionit, ku ky komision ka goxha një punë voluminoze dhe në fund atë punë do e prezantoj para anëtarëve të kuvendit.

Fehmi Cena – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, e përshtëndes iniciativën e znj. Boshnjaku rreth përpilimit të strategisë për personat me nevojë të veçantë, por mua më intereson se a ka biseduar znj. Boshnjaku me ata sepse ata i kanë disa OJQ të cilat mirën me interesat e tyre, mos kanë përpiluar ata ndonjë strategji, dhe nëse p atëherë ne kishte me qen mirë që të njoftohemi paraprakisht strategjinë e tyre dhe pastaj të kyçemi edhe ne, mendoj se do të ishte kështu një kontribut më i mirë dhe më gjithëpërfshirës.

Florije Boshnjaku – Po i nderuar z. Cena, në lidhje me këtë strategji kam biseduar me disa OJQ dhe Hendikosin, mendoj se është interes i përgjithshëm sepse ata kanë ide se si do të përpilohet strategjia. Po propozimi im është që ne si anëtar të kuvendit ta mbajmë një takim të përbashkët me ekzekutivin, Hendikosi dhe OJQ-të të cilat mirën me këto çështje dhe së bashku të fillojmë përpilimin e një strategje, sa jam në dijeni komunat e tjera e kanë përpiluar këtë strategji.

Munib Durguti - Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, gjithsesi që e përkrahi këtë ide të z. Florije Boshnjaku që kuvendi ta nxjerrë një strategji për persona me nevojë të veçantë, por ju njoftoj se vitin e kaluar ne si drejtori e kemi nxjerrë një strategji, me të cilën është angazhuar Qendra për Punë sociale, quhet strategjia e veprimit për ofrimin e shërbimeve sociale duke përfshirë edhe personat me nevojë të veçantë, po kjo nuk ka kaluar në kuvend sepse ka qen diku ka fundi i vitit sa më kujtohet, prandaj mendoj se kishte me qen mirë që edhe ato të gjetura të

inkorporohen në grupin punues i cili do të formohet nga kuvendi, në mënyrë që të kemi një strategji sa më gjithëpërfshirëse.

Rasim Fazliu – Në bashkëbisedim me propozuesen e kësaj çështje, u morën vesh që nga kuvendi të formohet një grupe punues e jo të jenë të angazhuar të gjithë anëtarët e kuvendit, pastaj ky grup të bashkëpunoj me Hendikosin dhe OJQ-të që dojen pjesëmarrëse.

Ali Zhuniqi – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem tek caktimi i grupit punues në lidhje me përpilimin e strategjisë për personat me nevojë të veçantë, znj. Florije Boshnjaku dhe z. Rasim Fazliu u morën vesh që të caktohet një grupe punues për përpilimin e draft strategjisë në fjalë, mendoj se në fillim shumë mirë e filloj znj. Florije, ku e ceku se kishte me qen mirë të takohen anëtarët e kuvendit, ekzekutivi dhe OJQ-të, mendoj se më pastaj duhet të caktohen anëtarët e grupit punues që do të merren me këtë strategji.

Rasim Fazliu – Ndoshëta më ka keqkuptuar kolegu sepse nuk e thash se unë dhe znj. Florije të jemi pjesë e atij komisioni, por kam thanë që nga ky kuvend të caktohet grupi punues i cili do e përfaqësoj kuvendin. E pastaj ky grupe të punoj me Hendikosin dhe OJQ-të, kështu e kam thënë, këtë e pata sa për sqarim.

Nënkyetari – Vetëm një sqarim desha të japë, është mirë që nga kuvendi të caktohet grupi punues nga çdo parti politike që është në kuvend, ku pastaj do të përfshihen edhe Drejtoria për Shëndetësi, Qendra për Punë Sociale, DKA-ja. Pra nëse doni ne mundemi ta formojmë këtë grupe punues, ju caktoni emrat e kuvendarëve pastaj edhe ekzekutivi i caktion dhe bëhet vendimi për formimin e kësaj strategjie.

Dervish Çadruku – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, si ide është shumë e mirë dhe me të vërtet ne këtë kategori e kemi lënë shumë mbrapa jo vetëm sot, çdo veprim që do të bëhet në drejtim të këtij përmirësimi është e mirëseardhur. Mendoj se tani ishim në pikën e dytë të rendit të ditës, mendoj se nuk është e domosdoshme tani kjo, mundemi ta kemi si pikët të rendit të ditës në mbledhjen tjetër e jo sot, sepse nëse ja nisim kështu atëherë do të jetë rendi i ditës goxha i ngarkuar. Kryesorja është që sinjali ishte shumë i mirë që të futet në rendin e ditës për me një material për mbledhje të ardhshme, pastaj ne do të kërkojmë njerëz adekuat të cilët do të punojnë në emër të Kuvendit dhe Komunës, pastaj të bëhet dokumenti i posaçëm i cili do të jetë valid dhe i pranueshëm për të gjithë, ne gjithashtu i kemi borxh shumë kësaj kategorie po ashtu mendoj se pak kush komunikon ose kontakton me ta, për atë institucionet tona duhet që të kenë qasje më shumë sepse kanë shumë nevoja.

Kryesuesi – Të nderuar znj. Boshnjaku e dha propozimin por nuk do të thotë që ne sot ta formojmë komisionin e punës, por le të shërbej si iniciativë që të fillojë përpilimi i strategjisë, pastaj mundemi në mbledhjen e radhës ti caktojmë grupet punuese.

Rexhep Oruçi – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, sa e kuptova znj. Boshnjaku propozimi i saj ishte që ta caktojmë një takim të përbashkët anëtarët e kuvendit dhe shoqatat e personave me nevoja të veçantë, propozimi imë kishte me qen që kur të mbahet ai takim të caktohen edhe përfaqësuesit e kuvendit të cilët do të punojnë në hartimin e strategjisë afatgjate dhe afatshkurtre.

Florije Boshnjaku – Të nderuar koleg ju falënderoj shumë për përkrahje, i nderuari z. Rexhep Oruçi propozimi im ishte ashtu siç e thatë ju, që ta mbajmë një herë një takim të përbashkët dhe në atë takim të merremi vesh për shumë çështje. Por për shkak të ngarkesës kolegu i nderuar e tha se kishte me qen më mirë që të propozojmë nga një përfaqësues të çdo subjekti, në mënyrë që mos të ngarkohem të gjithë anëtarët e kuvendit.

Ali Zhuniqi – Prapë po e them se shumë mirë e nisi propozimin në fillim znj. Florije sepse në fillim e tha se duhet të mbahet një takim, mendoj se për këtë strategji që jemi duke folur ka të bëjë me një kategori të ndjeshme dhe nuk e besoj se dikush nga anëtarët e Kuvendit dhe drejtoret do ta refuzojnë që të mbajnë një takim të tillë me persona të tillë. Është mirë që ne anëtarët e kuvendit të i dëgjojmë hallet e tyre dhe pastaj duke i dëgjuar kërkosat e tyre ne mundemi me marrë ide për përpilimin e Planit Strategjik për Personat me Nevojë të Veçantë.

Nënkyetari – Kishte me qen mirë që të merreni vesh a do të jeni në takim të gjithë kuvendarët apo do të përfaqësoheni me nga një anëtar, po ju pyes për arsyen se ne të dimë dhe ta caktojmë një datë për këtë takim.

Mirjeta Krasniqi – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, desha të informohem nga nënkyetari i komunës sa i përket palestrës në Rahovec, kemi parë në rrjete sociale që keni nënshkruar një marrëveshje me MKRS – në, por kishte me qen mirë që të njoftohemi edhe ne si këshilltar komunal dhe të dimë se cilat janë obligimet e kësaj marrëveshje, a do të kemi obligime ne si Komunë etj. si iniciativë e përvëndesim sepse çështja e palestrës është

stërvjatur shumë. Pjetja e dytë shkon për Drejtorin e Shërbimeve Publike, projekt i cilin e keni nënshkruar me Demosin, për krijimin e hapësirave gjelbëruese, i nderuar drejtor tek banesat që janë këtu afër komunës është një hapësirë që do të ishte shumë mirë nëse do të kishit pasur mundësi të ndërtoni një park ose kënd lojërash përfëmijë, pasi që e keni nënshkruar marrëveshjen me Demosin, kjo ishte kërkesë e banorëve të kësaj ndërtesa që mu kanë drejtuar mua.

Fjolla Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë nga banorët e Krushës së Madhe gjegjësish nga prindërit e fëmijëve të shkollës “Bajram Curri”, për shkak se trotuaret zihen nga vetrurat e parkuara si nga mësimdhënësit ashtu edhe nga banorët e Krushës së Madhe, fëmijët e kësaj shkolle nuk ecin të lirë në trotuare si rrjedhojë e incidenteve dhe aksidenteve të ndryshme si shkelje të fëmijëve. Kërkesa jonë është që në ato trotuare të vihen pengesa ose të mbjellën drunjë dekorativ.

Aferdita Thaqi — Përshtetje për të gjithë të pranishmit, do e ngrisë një çështje shumë serioze thuajse alarmante përfshirë fshatin Çifllak, janë më shumë se katërmbëdhjetë familje që nuk kanë kanalizim dhe ujë të pijes, gjatë reshjeve atmosferike janë tokat janë përfshirë nga kanalizimet, bujqit nuk kanë ku ta mbjellin as një sallatë jeshile sepse ajo i merë toksina. Nuk e di pse nuk është punuar deri më tanë përfshirë vendosjen e kanalizimeve dhe ujë të pijes kur këto dy gjëra besoj se janë gjérat etike përfshirë. Shqetësimi tjetër është tek fusha e sportit, nuk ka fare trotuare ka pas disa raste ku janë goditur nga vetrurat njerëzit, por përfshirë mirë kanë qen jo me fatalitet, po ashtu këtë rrugë e frekuentojnë edhe fëmijët, prapë po e them nuk e di arsyen pse nuk është duke u ndërtuar një trotuar aty sepse mendoj se nuk kushton shumë ndërtimi i një trotuari. Shqetësimi i tretë është tek rruga e xhamisë në rrugën ku kalojnë nxënësit përfshirë shkurti përfshirë shkuan tek autobusi, i takoj shpesh herë nxënësit e mjekësisë kur vinë përfshirë praktikën dhe gjithmonë i kanë këmbët e lagura, kishte me qen mirë që edhe ajo pjesë e rrugës të ndërtohet.

Qazim Qeska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e parashtoj një kërkesë alternative për Drejtorin e Urbanizmit ose për Drejtorin e Shërbimeve Publike, rrëth dorëzimit të një informate në formë të shkruar për securinë e projektit të rregullimit të pjesës së vjetër të qytetit, që konsiston në dy rrugë, truga “Bekim Sylka” dhe pjesa e rrugës “Ali Sokoli”. Arsyetimi për këtë kërkesë është se të dy rrugët që janë pjesë kryesore të qytetit janë në gjendje të mjerueshme, por besoj se do të marrim në formë të shkruar, nëse kolegët e tjerë nuk janë të interesuar, kishte me qen mirë që të më sillet vetëm mua informata.

Ali Zhuniqi – Desha të ngrisë një çështje sa i përket fushë së shëndetësisë në Rahovec, ku besoj se shumica nga ju e keni parë rastin edhe në televizion. Ky raste ka të bëjë me çështjen e trajtimit të pacientit në kohën dhe momentin e duhur, në bazë të deklaratës së familjarëve që është dhënë pacienti me emrin Hilmi Dermala, është pranuar nga mjeku përgjegjës kujdestar në ora 6:40 minuta, ku pastaj është urdhëruar për të bërë një EKG por ajo nuk ka funksionuar në atë moment, ku pastaj nga aty nga mjeku përgjegjës është urdhëruar që pacienti të shkojë të trajtohet për mjekim në një tjetër objekt brenda qendrës klinike të mjekësisë familjare. Infermieri përgjegjës së bashku me pacientin ka shkuar për ta trajtuar pacientin, kurse mjeku i cili ishte përgjegjës për mbajtjen e ndërrimit nuk ka qenë prezentë gjatë asaj kohe, po ashtu ka pasur vonesa edhe nga mjekët të cilët kanë pasur për ta pranuar ndërrimin në mëngjes. Për mua është e arsyeshme që të vonohen 15 minuta por nuk është e arsyeshme për mjekun kujdestar që ta liroj punën pa u bërë pranim dorëzimi i punës. Si çështje kjo për mua është jashtëzakonisht e ndjeshme mendoj se drejtori i shëndetësisë dhe kryetari i komunës e kanë mare seriozisht këtë çështje sepse sot i ka ndodhur këtij zotëri, nesër mundet me i ndodhë prindit tim. Dua ta di se cilat janë masat e ndërmarrja nga Drejtoria e Shëndetësisë, ose a ju ka shqiptuar personit përgjegjës masa disiplinore dhe nëse po cilat janë ato masa.

Kryesuesi – Inderuari z. Ali Zhuniqi ju lutem të jeni konkret në pyetje e të jepni pjesë të analizave.

Ali Zhuniqi - Ju mundeni të quani pjesë të analizave por ne jemi këtu përball qytetarëve të cilët kemi përgjegjësi ndaj tyre, ta dini se ky nuk është rasti i parë po ashtu e di se këto çështje shkojnë përmes prokurorisë dhe prokuroria del me një vendim në lidhje me personin përgjegjës se a ka qen fajtor apo jo. Pres sqarime nga drejtori i shëndetësisë.

Fehmi Cena – Desha të bëjë një ndërhyrje për këtë rast sepse jam duke punuar në atë institucion dhe jam në ngjarje për këtë ndodhi, mendoj se çështjet e tillë nuk është rendi për tu ngritur këtu sepse është rast individual,

diku 300 – 400 persona vizitohen brenda dite në QKMF-në e Rahovecit, shumica prej tyre shërohen, por dikush edhe vdes. Kjo ndodhë edhe në QKUK ku edhe zotëria punon, janë organet kompetente që mirën me këto raste si Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e QKMF-së, komisionet pranë QKMF-së etj. por nëse parafolësi kërkon vetëm raportin final nga një çështje atëherë në rregull, por ta dini se aty ka edhe shumë lëvdata brenda dite dhe shumë ankesa nga pacientët dhe nëse merremi ne me të gjitha këto atëherë për ne do të ishte vetëm humbje kohe, kishte me qen mirë që të shikohet mirë se çfarë çështje duhet të debatohet në mbledhje të Kuvendit, pra atë çështje që janë në interes të përgjithshëm të diskutohen e jo çështjet individuale.

Nënkryetari – Desha të kyçem sa i përket kësaj çështjes që e ngriti z. Ali Zhuniqi, të nderuar ky raste është në prokurori dhe për çdo gjë që ne sot bisedojmë rrëth këtij rasti vetëm sa i komplikojmë hetimet, prandaj nuk e besoj se duhet që të diskutohet më tepër.

Faton Ramadani – Përshtësia për të gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtoshës për Shërbime Publike, desha të ngrisë një shqetësim përrugët në fshatin Celin, fatkeqësishët në fshatin Celin rrugët janë shumë të ngushta, janë një tre udhëkryqe shumë të rrezikshme dhe vazhdimisht ndodhin aksidente në këto udhëkryqe, paramendoni për një ditë në këto udhëkryqe kanë ndodhur tre aksidente. Mendoj se në këto udhëkryqe ka nevojë që të mirën masa emergjente, të vendosen disa pasqyre ose të ndërtohen rrëthrotullime, kjo ishte kërkësë e banorëve të fshatit Celin.

Besmire Bytyqi – Përshtësia për të gjithë të pranishmit, pyetje ime shkon për Drejtoren e DKA-së, disa mësimdhënëse që janë duke zëvendësuar nëpër shkolla më janë ankuar, një raste konkret është në fshatin Xérxë, kjo mësimdhënëse ka filluar zëvendësimin në muajin shkurtë konkretisht pas pjesës së dytë të muajit shkurtë dhe ende nuk e ka mare asnjë pagë. Desha një përgjigje nga drejtori i DKA-së, a ka qen mos planifikim i duhur dhe çka do të bëjë drejtoria e DKA-së lidhur me këtë çështje.

Bjondina Kleçka – Përshtësia për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem rrëth çështjes së kamerave në shkolla, pajtohem që vendosja e kamareve siguron sigurinë më të madhe, por pyetje ime është: sa janë funksionale këto kamera sepse sipas disa informatave që i kam në shkollat e mesme janë të vendosura kamerat, por në shkollat filllore mungon kjo iniciativë, dua ta di se sa qëndron kjo çështje dhe a ka ndonjë plan rrëth kësaj, përderisa incidentet në mes nxënësve ndodhin sidomos gjatë kësaj periudhe.

Refki Kryeziu – Përshtësia për të gjithë të pranishmit, Komuna jonë në fillim të muajit mars ka pritur në takim ministrin z. Palë Lekaj dhe zëvendësministrin z. Fehmi Mujota, ku komuna jonë ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës memorandum e mirëkuptimit në vlerë prej 1,663,000.00 €, në përmirësimin infrastrukturës rrugore në projektet ekzistuese të cilat janë të paraparë në proceduar por edhe për projektet e tjera. Pasi është një vlerë e konsiderueshme e mjeteve është kërkësë e qytetarëve të fshatit Xérxë në formë të peticionit, që në këtë vite të filloj rregullimi i këtyre rrugëve: Rruga e ish stacionit të trenit me gjatësi 300 metra, rruga “Nëna Terezë” me një gjatësi 600 metra ku e frekuentojnë më shumë se 30 shtëpi, rruga “5 maji” rrugë e varrezave të fshatit Xérxë me gjatësi mbi 600 metra gjysma e shkatërruar, rruga “Rystem Kryeziu” me gjatësi afro 350 metra ku kjo rrugë me shumë krenari e mbanë emrin e një ushtari të UÇK-së, i cili pas përfundimit të luftës humbë jetën aksidentalisht. Familja e këtij dëshmori e as lagja nuk ka as kanalizim e as asfaltim ose kubëzim të rrugës, po ashtu edhe një dukuri negative jam duke e hasur çdo ditë pasi punoj në qytetin e Rahovecit, shqetësimi i qytetarëve është mos kujdesi ose mospastrimi lumit Dullo, kishte me qen mirë që të kontraktobet një kompani dhe të pastrohet shtrati i lumit Dullo, po ashtu kishte me qen mirë që të bëhet edhe rregullimi i shtratit të lumit Rrimnik sepse për arsyet e mos rregullimit ky lumë çdo vite del jashtë shtratit ku ju shkakton dëme të pa konsiderueshme bujqve tanë që i kanë tokat rrëth lumit Rrimnik.

Rasim Fazliu – Dje mbas mjeteve të informimit dëgjova se qeveria komunale ka pasur takim me banorët e fshatit Drenoc për dëgjime buxhetore, kryetari mirë ka bë që ka shkuar sepse është i zgjedhur nga qytetarët dhe ka drejtë të takohet me qytetarë, mirëpo për dëgjime buxhetore konsideroj që duhet dhe është e drejtë ligjore që të merr pjesë edhe anëtarët e KPF-së, pyetje ime është: A keni ndonjë agjendë se ku do të mbahen këto tubime dhe a do të i kryeni vetë apo do të jemi të ftuar edhe ne si anëtar të KPF-së.

Përparim Krasniqi – Përshtësia për të gjithë të pranishmit, znj. Mirjeta pati një pyetje rrëth Demosit, po e nderuar ne kemi bërë dy marrëveshje me Demosin, një për ndriçim publik në fshatin Xérxë, kurse marrëveshja

tjetër është për gjelbërim të hapësirave publike në qytet. Ne në bashkëpunim me drejtorin e urbanizimit do ti caktojmë si prioritet se cilat janë hapësirat publike që duhet të i rregullojmë ne, sa i përket kërkjesës tënde ajo është prapa banesave dhe të flasim realisht ka shumë këso lloj hapësirash që kanë nevojë për gjelbërim në qytet, po ashtu e di se si është gjendja me mbeturina aty, ku ju edhe më parë keni kërkuar nga unë që ti largojmë ato mbeturina, ne do të shikojmë së pari mundësin që ti largojmë ato mbeturina dhe pastaj të vendosim një tabelë me mbishkrim për mos hedhje të mbeturinave. E nderuar mjetet buxhetore janë të kufizuara dhe me 25,000.00 € ndoshta nuk kemi mundësi me bë shumë hapësira gjelbëruese. E nderuara znj. Fjolla Duraku pyeti rrëth uzurpimit të trotuareve, po e nderuar është e vërtet nuk është vetëm në Krushe të Madhe por në çdo vendbanim kemi uzurpim të trotuareve, ne kemi kërkuar edhe nga policia që të kenë një angazhim shëthesë, gjithashtu kërkoj nga ju që të kontaktoni me kryetarin e këshillit të Krushës së Madhe që të kontaktoj ai me policin, që së paku të fillojnë të lëvizin policia edhe nëpët vendbanime të mëdha dhe të kujdesen që të mos ketë uzurpim të trotuareve ose mos siguri për lëvizje nga nxënësit. Znj. Afërdita Thaqi pyeti për çështjen e kanalizimeve dhe ujtit të pijes, e nderuar jam i njostuar ne kemi filluar një iniciative për identifikimin në 4 pozicione sa i përket drejtorisë së shërbimeve publike e ato janë: Ndriçimi publik, kanalizime, ujë të pijes dhe trotuare, në këto katër pozicione inxhinierët tanë kanë filluar në çdo vendbanim së bashku me kryetarët e fshatrave të i identifikojnë ato vendbanime të cilat nuk kanë këto segmente. Këtë vit e kemi në planifikim ndërtimin e një rrugë që është në planifikim në bazë të vitit 2017, ne nuk kemi mundësi me bë diçka më tepër, por kur të fillojnë planifikimi i buxhetit 2019 është mirë që së bashku me ju dhe këshillat e fshatrave të i propozoni këto shqetësimë që janë duke i ngritë në kuvend dhe në buxhetin e vitit 2019 të janë si prioritete. Z. Faton Ramadani pyeti për rrugë të ngushta dhe udhëkryqe që janë në fshatin Celin, po i nderuar jam i njostuar për këtë, sa i përket vendosjes së disa pasqyrave në udhëkryqe kjo është e rregulluar ne jemi në fazën e kontraktimit të kompanisë për sinjalizimin vertikal dhe horizontal, në momentin që kontraktohet kompania ne jemi në dispozicion, por kishte me qen mirë që nga ju të vije vetëm një kërkësë zyrtare se ku mendoni se duhet të vendosen. Kurse sa i përket çështjes së rrëth rrrotullimit ose zgjerimin e rrugëve, është mirë që në planifikimin e vitit 2019 ta propozoni si kuvendarë në mënyrë që ne të i fusim të dhënat, përndryshe ne në këtë vit nuk kemi mundësi për shkak të limiteve buxhetore që i kemi. Z. Refki Kryeziu pati pyetje për rrugët në fshatin Xërxe, gjithashtu edhe për këto kishte me qe mirë që nga ju të vinë propozimet kur të bëhet aprovimi i buxhetit për vitin 2019, siç e dini buxheti aprovohet 1 vit përpara dhe ne në këtë vit nuk kemi mundësi të bëjmë diçka më tepër përveç ndriçimit publik që do të bëhet këtë vit në fshatin Xërxe diku 6.5 km. Sa i përket çështjes së marrëveshjes mes ministrisë së infrastrukturës dhe Komunës, në këtë është e paraparë rrëth rrrotullimi në unazën Prizren – Gjakovë, ku do të ndërtohet edhe një nënkalim aty, por kjo është çështje e ministrisë se kur do të fillojnë me punime, kontrata është e lidhur që një vit, arsyen pse nuk po ja fillojnë punimet ne nuk i dimë.

Nënkyetari – E kam një përgjigje për znj. Mirjeta Krasniqin sa i përket palestrës sportive, e nderuar komuna ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me MKRS dhe në bazë të këtij memorandumi komuna e Rahovecit i zhvillon vetëm procedurat tenderuese, kurse mjetet i ka MKRS, ne jemi në cilësinë e mbikëqyrësit kurse ekzekutimi i pagesave bëhet i gjithi nga ana e ministrisë. Dje është bërë hapja e ofertave dhe pritet të formohet komisioni i cili do të bëjë vlerësimin, pastaj janë procedurat e ankesave e kështu me radhë, por besoj se shumë shpejtë do të kryhet kjo punë dhe do të fillojmë me rregullimin e palestrës sportive. Kurse sa i takon pyetjes së kolegut z Rasim Fazliu rrëth dëgjimeve buxhetore, po i nderuar është një premtim i kryetarit të komunës që dëgjimet buxhetore do ti mbajmë në çdo vendbanim, ne kemi bërë një plan edhe me anëtar të KPF-së, së bashku me kryesuesin, ekzekutivin, besoj se do të njostoheni me kohë se kur do të fillojnë dëgjimet buxhetore me anëtarët e KPF-së.

Rumir Zhuniqi – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, kuvandari z. Qeska parashtroj një pyetje sa i përket projektit Qendra e vjetër e Qytetit, i nderuar ky projekt ka filluar para dy viteve dhe është projekt në vazhdim. Me të mare pozitën e Drejtorit të Urbanizmit kamë dalë në teren së bashku me inxhinierët e komunës, u kemi vlerësuar se punimet aty nuk janë kryer me kualitet të mirë, kryetari i komunës ka krijuar një komision të inxhinierëve dhe arkitektëve të komunës të cilët kanë vlerësuar se punimet nuk janë kryer në bazë të projektit, paramasës etj. Si drejtor kam kërkuar nga operatori që të i kryej punimet në bazë të projektit, operatori nuk donë

të i kryej punimet ashtu siç janë në kontratë, kështu që ne jemi të detyruar që të marrim të gjitha masat ligjore që ky projekt të kryhet sipas kontratës.

Kryesuesi - Pasi nuk kemi ndonjë përgjigje tjetër nga ndonjë drejtor, atëherë kalojmë në pikën e radhës:

3.Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolomi i objekteve ndërtimore.

Përparim Krasniqi – Duke u bazuar në ligjin për mbeturina inerte, në nenin 15 përgjegjësit e komunës pika 1 ceket: Duke respektuar procedurat e prokurimit për zgjedhjen e personave të licencuar për grumbullimin e mbeturinave, kemi pastaj një udhëzim administrativ 01/2017 ku ceket: në listën e aktiviteteve që i nënshtrohen lejeve komunale ceket se qendra për grumbullimin e mbeturinave nëpër komuna kanë të drejtë ata komuna që kanë më pak se 60 mijë banorë. Pastaj udhëzimi tjetër administrativ 07/2015 , ku në pikën 1 ceket: Komuna brenda territorit të tyre caktojnë qendra për grumbullim; demolim të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit. Pra ne e kemi cekur një lokacion që është pronë komunale me një hapësirë prej 1.5 hektar, aty është një gropë e krijuar nga natyra dhe me ligje i plotëson kriteret për vendosjen e mbeturinave inert, para jush e keni edhe një leje mijedisore që e ka bërë një ekspert nga Demosi. Tani ne kërkojmë nga ju që ta mbështhesni këtë pikë për arsy se është interes i të gjithëve që komuna jonë të ketë një mijedise të pastër.

Masar Popaj – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, e përshtendesë këtë propozim vendim që na ka ardhur nga qeverisja komunale sepse është një propozim i rëndësisë së veçantë caktimi i lokacionit për hedhjen e mbeturinave inerte, në çdo vendbanim të komunës sonë hasim në grumbuj mbeturinash inerte të cilat janë pengesë për qytetarë. Pyetje ime për drejtorin është: Për ngritjen e kësaj deponie a janë siguruar mjetet financiare dhe nëse po çfarë masa do të ndermirën nga qeverisja komunale për vetëdisimin e qytetarëve në mënyrë që qytetari të jetë i vetëdijshëm që duhet të dërgojë mbeturinat në vendin e caktuar nga komuna. Pastaj a kemi ne një rregullore për mbeturina apo mbetet që ne të aprovojmë një rregullore në të ardhmen.

Rasim Fazliu – Ne kemi diskutuar edhe në KPF rrëth kësaj teme, ku jemi dakorduar që të kalojë në kuvend kjo pikë, ky është një propozim shumë i qëlluar dhe është shumë mirë që është marr ky hapë për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte, nga ndërtimi dhe demolomi i objekteve ndërtimore. Ne si grupe i PDK-së e mbështesim plotësisht këtë propozim, ky ishte mendimi im prandaj kanë të drejtë edhe kolegët e tjera të jepin mendimin e tyre. Ajo që më ka lënë përshtypje mua është Raporti për Leje Mjedisore Komunale për komunën e Rahovecit i cili është hartuar nga MMPH, në këtë raport shumë flitet për biodeversitetin, bifurkacionin ane kënd Kosovës, kurse shumë pak flitet për lokacionin për të cilin ne sot jemi duke diskutuar, por nuk ka gjë se nuk janë të dëmshme edhe këto informata. Pra ne jemi të pajtimit por vetëm që mos të ketë efekte në dëme anësor, pastaj kjo deponi a do të menaxhohet nga komuna apo do të jepet ne menaxhim dikujt tjetër.

Florida Bajraktari – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, mendoj se ne të gjithë anëtarët e kuvendit komunal duhet që ta përkrahim këtë propozim vendim, pasi që ky lokacion ka qasje të mirë si për qytetin ashtu edhe për fshatrat, mendoj se kjo zonë është shumë e përshtatshme për deponimin e mbeturinave inerte, po ashtu këtu ceket se në afërsi të këtij lokacioni nuk ka ndonjë objekt afaristë, por janë disa toka që dikur janë punuar për vreshtari, të cilat edhe sot vazhdojnë të janë vreshta.

Dervish Çadranku – Është shumë e vërtet se mbetjet inerte janë bërë problemi i madhe për Kosovën dhe komunën tonë pasi jemi duke diskutuar konkretisht, mbetjet inerte dhe plastiket janë probleme që i ka e gjithë bota, prandaj pyetje ime është a ka dëme rrathi nëse vendoset në këtë pjesë kjo deponi, pastaj në këtë pjesë duhet të ndërtohet një rrithojë në mënyrë që mos të kenë qasje njerëzit sepse ne kemi raste ku kemi deponi ilegale në gjithë territorin e komunës sonë, pastaj ata shkojnë e heqin zhavorrin nëpër lumenj dhe i mbushin me këto mbeturina. Prandaj kishte me qen mirë që të formohen edhe në pjesët e tjera të komunës këto deponi legale, sepse qytetari ndoshta nuk ka mundësi të vije nga Kramoviku të i hedhë mbeturinat në Rahovec.

Ali Morina – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, caktimi i deponisë për mbeturinat inerte është një hapë shumë i rëndësishëm me qëllim të ruajtjes së ambientit dhe menaxhimin e mbeturinave, një hapë i tillë ndikon drejtpërsëdrejti në ruajtje të ambientit dhe nuk lejon degradimin e natyrës. Inkurajojmë organet kompetente që të kujdesen dhe të inspektojnë të gjitha vendbanimet me qëllim të mos lejimit të hedhjes së mbeturinave dhe

krijimin e deponive ilegale siç ka qen deri më tani. Po ashtu e mbështesim iniciativën e Drejtorisë së Inspektoratit për shqiptimin e gjobave mandatorë e cila nuk e besoj se e ka për qëllim dënimin e qytetarëve por besoj se e ka për qëllim vetëdijesimin e tyre, po ashtu mbështes propozimin e z. Drevish Çadrankut që deponitë e tilla të caktohen edhe në lokacione të tjera me qëllim të ofrimit sa më afër të qytetarëve.

Fehmi Cena – Edhe unë mendoj përderisa ne si komuna kemi mbeturina të tilla inerte, kemi nevojë edhe për deponi, kjo deponi tani është caktuar. Mendoj se duhet të ketë më shumë deponi në Komunën tonë, kjo deponi është në periferi të qytetit dhe nuk është mirë që të gjitha mbeturinat nga e gjithë komuna të hedhen në një vend për shkak të shtrirjes gjeografike që e kemi ne si komunë. Kishte me qen mirë që një deponi të jetë në pjesën e Gradishit dhe një deponi në pjesën ka Krusha. Elementi tjetër është sigurisht ndotja e ambientit që u cekë nga parafolësit, kam shqetësimin time se aty afër kalon edhe lumi rimnik, uroj që kjo deponi të realizohet në formë të standardeve të mbrojtjes ambientale, të kihet parasysh që lumi rimnik të mos ndotet sepse është një lumë i cili është arterie më e madhe për fushën e qytetit të Rahovecit, uji përdoret për ujitje të fushës, prandaj ne duhet të kemi pak më shumë kujdes në këtë drejtim. Pastaj duhet të shikohet edhe aspekti arkeologjik, ky vend edhe ashtu quhet Sejana dhe në këtë vend ka qen në qytet i lashtë Ilir diku 2000 vjeçar vlerësohet, prandaj është mirë që t shikohet mos të mbulohet diçka që është me vlerë arkeologjike. Këtë jam duke e thënë sepse kemi një shembull në qytetin e Rahovecit ku një objekt me vlerë trashëgimore që quhet Ura e Filës është e mbuluar me mbeturina, kjo urë është e vjetër mbi 2000 vite, prandaj ne duhet të bisedojmë në të ardhmen për këtë objekt sepse është i rëndësisë kulturore dhe historike. Sa i përket terminologjisë e kam vërejtur se në dokumentacionin e Drejtorisë së Gjeodezisë, terminologjia përdoret kryesisht me terma sllave, propozoj që të përdoren edhe me terma shqip, nuk jam që të ndryshohen emrat, por të shkruhen ashtu siç i përdorë popullata shumicë. Ne e dimë se regjimi paraprak ka bërë diskriminime edhe në aspektin gjuhësor duke përfshi edhe toponimet gjeografike, prandaj ne duhet që të kemi kujdes në të ardhmen.

Përparim Krasniqi – Faleminderit për pyetje, po ju përgjigjëm me radhë, z. Masar Popaj sa i përket rregullores komunale është e miratuar në kuvend, Plani Për Menaxhimin e Mbeturinave, pra edhe me ligj edhe me udhëzim administrativ i plotëson të gjitha kriteret ky lokacion për grumbullimin e mbeturinave. Z. Rasim Fazliu pyeti për ekspertin mjedisor, është e vërtet i nderuar ne e kemi gjetur një dokument i cili ka dalë para një viti, prandaj kemi menduar që është një dokument shtesë që ju nevojitet për më shumë sqarime. Kurse sa i përket asaj se kush do e menaxhojë këtë deponi, kjo është e rregulluar me ligj, kjo do të del në ankand publik ose do të bëjmë përmes tenderimit të komunës sepse aty duhet të vendoset një rrëthojë, rrënya elektrike, duhet të rregullohet rruga, po ashtu duhet që të punësohet dikush i cili do të kujdeset për menaxhimin e mbeturinave inerte sepse do të bëhet një ndarje e mbeturinave, ato që janë nga demolimet do të vendosen në njëren anë kurse dheu do të ndahet në pjesën tjetër me qëllim që kur të mbushet ajo gropë do të hedhet një sasi e dheut, në mënyrë që në të ardhmen kjo të bëhet një tokë e cila do të shfrytëzohet për të mbjella. Z. Dervish Çadranku pyeti a ka dëme nga kjo, i nderuar unë mendoj se nuk ka dëme sepse është një gropë natyrale dhe sipas ligjit kjo gropë i plotëson kushtet sepse në atë pjesë nuk ka as rrjedha të lumenjve dhe nuk ka kurrrfarë reziku për dëmtim të tokave bujqësore. Ne në të ardhmen do të fillojmë që ti identifikojmë edhe disa vendbanime të tjera në komunën tonë, në ligje thuhet se edhe në gropë ujore që janë krijuar është e drejtë të mbushen edhe këto gropë, por ne do të shikojmë mundësin që të shikojmë se sa janë prona komunale dhe sa i plotësojnë kriteret që të caktojmë edhe lokacione të tjera për vendosjen e deponive inerte. Kjo ishte edhe një përgjigje për z. Fehmi Cena sa i përket pyetjes që e bëri ai, pastaj në këtë pjesë nuk ka asnjë rrjedhë të lumi, ky lokacion është diku 1 km larg lumi rimnik. Është diku 500 metra larg rrugës kryesore, ne si drejtori do të kujdesemi që ti vendosim tabelat informuese dhe rregullimin e rrugës deri në deponi, deri sa të planifikojmë për vitin e ardhshëm një buxhet për ta trajtuar ashtu si duhet kjo deponi inerte.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim Vendimin për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolomi i objekteve ndërtimore: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3). Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme në fshatin Ratkoc.

Afrim Oruci – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë ka pranuar një kërkesë në lidhje me incizimin dhe evidentimin e pronave shtetërore komunale në zonën Kadastrale në fshatin Ratkoc, i cili ka të bëjë me një projekt përfushë të sportit, ky donacion është i siguruar nga MKRS-së, por nga ne është kërkuar që të gjejmë një lokacion prej 2 hektarëve në lidhje me implementimin e këtij projekti. MKRS-ja ka angazhuar një kompani projektuese e cila e ka mare përsipër me e bë projektin e stadiumit të futbollit përfshatin Ratkoc, ne kemi prona komunale ku aktualisht është stadiumi i fshatit, ne në kufi i kemi pasur katër prona komunale por të gjitha këto përfshak të shtrirjes nuk kanë ofruar metra katror të nevojshëm përfillimin e projektimit të fushës së sportit. Ne e kemi bërë inqizimin edhe të fushave të tjera komunale si në fshat ashtu edhe përreth fshatit Ratkoc, ku ka qen e pamundur që të sigurohen 2 hektar, kemi ra në kontakt me pronarë privat të cilët kufizohen me parcelën kadastrale komunale ku aktualisht është fusha e sportit, po flasim përfshakët e parcelëve kadastrale 241/2, është prona private dhe pronë e klasit të njëjtë me pronën komunale e cila kufizohet me parcelën 241/2, është pronë bujqësore kulloso e klasit të dytë. Ne kemi kontaktuar me pronarët e kësaj parcele ku jemi dakorduar në parim me marrëveshje përkëmbim të pronës në bazë të ligjit 04L/144 nenit 11, fillimisht pronarët kanë kërkuar nga ne që të këmbehet prona në interes të përgjithshëm 2 me 1, pas disa takimeve që i kemi pasur me ta dhe pasi është interes i përgjithshëm, interes i klubit dhe i fshatit, pronarët privat janë dakorduar që të këmbehet prona 1 me 1. Ne kemi dalë në teren ku e kemi inqizuar vendin, para jush e keni një skicë, siç e shihni pjesa private është në vijë me parcelën shtetërore dhe pjesa tjetër që është e hijezuar është pjesë komunale që ne e kemi parapë që ta këmbejmë, pra kjo parcelë i ka 25 ari. Kjo është duke u bërë me qëllim të interesit të përgjithshëm dhe në bazë të ligjit, prandaj kërkoj nga ju që këtë propozim vendim ta shqyrtoni dhe në fund ta përkrahni dhe ta votoni.

Rasim Fazliu – Edhe në mbledhjen e KPF-së e kemi shqyrtuar këtë çështje ku ka pasur pyetje përdrejtoren se a kanë pasur marrëveshje me pronarët e pronës private, drejtori na është përgjigjur se kemi marrëveshje, ne kemi verifikuar dhe është e vërtet që ata janë dakorduar sepse është interes i përgjithshëm publik ndërtimi i stadiumit të futbollit në fshatin Ratkoc. Pastaj shumë mirë është që financimi i këtij stadiumi është duke u bërë nga MKRS-ja, ne si grupe e mbështesim këtë propozim vendim sepse mendojmë që është duke u bërë një punë e mirë, është shumë mirë kur përkrahet rinia jonë dhe kur i krijohen kushtet e mira përsportive.

Ali Morian – Ne konsiderojmë që një vendim i tillë duhet që të mbështetet dhe ndoshta ky vendim është i vonuar dhe është dashur që ti jepet zgjidhje më herët, besojmë se projekti i ndërtimit të stadiumit në fshatin Ratkoc nga ana e MKRS-së të merë epilogë tash më e sa vite. Ne e dimë se projektbuxheti i MKRS para disa vite është parapë në buxhetin e ministrisë, por pikërisht përfshak të këtyre pengesave është zhagitur deri më tanë, ne si grupe i AAK-së i japim mbështetje të plotë dhe urojmë që ky projekt të përfundojë sa më parë.

Dervish Çadraku – Është shumë mirë që është caktuar një vend përfshakët e fshatit Ratkoc, nuk e di a e kanë pasur ata ndonjë herë ndonjë fushë sportive sepse ne në fshatin Malësi e Vogël e kemi një por nuk ka kush të luaj, e gjithë rinia ka shkuar në perëndim dhe atje i zhvillojnë aktivitetet sportive. Qeveria jonë me politikat e sajë nuk e di kujt është duke ja ndërtuar këto stadiume, problemi qëndron se ne nuk i kemi politikat e mira ndaj rinisë, është duke u bërë është shumë gjë e mirë dhe ndoshta ashtu siç e tha z. Morina është i vonuar, rinia duhet që ti kthehet vendit dhe vendi duhet që të bëjë politikat e mira. Kishte me qen mirë që edhe në vendet e tjera si Krushe, Malësi të Vogël dhe vendet e tjera të i aktivizoni këto klube sportive dhe rinia të mirët me këto aktivitete në mënyrë që të largohet nga disa veprime të këqija që jemi duke i dëgjuar çdo ditë nëpër media. Prandaj ne e përkrahim këtë propozim vendim.

Florida Bajraktari – Shefi i grupit vetëm e ceku që ne e përkrahim këtë propozim vendim, normalisht që edhe unë jam pro këtij propozim vendimi përkëmbim të pronës private me atë komunale, pasi që është interes publik dhe ky është investim nga MKRS-ja, pra neve nuk na mbetet asgjë tjetër vetëm që ta përkrahim këtë propozim.

Fehmi Cena – Edhe ne si grupe e përkrahim këtë vendim pasi konsiderojmë që është në interes të qytetarëve, këmbimi i pronës publike me atë private e përkrahim pasi që shkon në favor të zgjerimit të fushës së sportit në fshatin Ratkoc, pra ne jemi pro kalimit të këtij propozimi.

Ali Morina – Desha vetëm një sqarim për z. Dervish Çadrakun, këtu bëhet fjalë përfushën aktuale të sportit në fshatin Ratkoc, ku aktualisht garat i zhvillon klubin KF Ratkoci dhe KF Dejni.

Afrim Berisha – Pëershëndetje përfshirë gjithë, sa i përket ndërtimit të stadiumit në fshatin Ratkoc, mendoj se është një ide shumë e qëlluar, por përfshirë min e kësaj fushe nevojiten diku 3 vite kohë, prandaj mendoj se duhet që të ndërtohet edhe fusha e sportit në fshatin Dejnë së paku si fushë e dytë dytësore pasi që edhe KF Dejnë është duke i zhvilluar garat në ligën e dytë të kampionatit të Kosovës.

Ali Zhuniqi – Mirë ja ka nisë kryetari, me fshatin Ratkoc shumë mirë ja ka filluar jemi duke parë që nga pak ka filluar të gjallërohet fshati Ratkoc, ne jemi pro këtyre iniciativave dhe normal që do i mbështesim këtë iniciativa, tanë z. Berisha është duke e kërkuar edhe në fushë dytësore përfshirë ti zhvilluar ushtrimet kurse ndeshjet të mbahen në Ratkoc, mendoj i nderuari z. Berisha që investimet kishte me qen mirë që ti orientojnë edhe në fshatrat e tjera. Jam duke parë që ky investim është nga MKRS-ja dhe shumë mirë kryetari që ja ka dhënë këtë investim fshatit Ratkoc, por kishte me qen mirë që të dilet në teren dhe të shikohet se kush ka nevojë sepse edhe Fortesa ka bërë shumë herë kërkesa të tilla por asnjëherë nuk ka përfituar diçka nga komuna.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim Vendimin përfshirë këmbim të pronës së paluajtshme komunale në fshatin Ratkoc: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm përfshirë Drejtorin përfshirë Punë Inspektuese.

Binak Kryeziu – Pëershëndetje përfshirë gjithë të pranishmit, në kuadër të inspektimit të parë të njësisë së auditimit të brendshëm përfshirë drejtorin inspektuese është bazuar në planin e parë të punës përfshirë vitin 2018, ku si bazë ligjore kemi pasur ligjin përfshirë auditimit të brendshëm, udhëtimet dhe rregullloret. Fushëveprimi i auditimit ka qen muaji shkurt dhe mars, kurse auditimi është kryer përfshirë 6 majoren e dytë të vitit 2017 dhe dy majoren e parë të vitit 2018, aktivitetet tona kanë qenë kryesisht në përcaktimin e objektivave dhe verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve. Në këtë raport janë përcaktuara gjashëtë objektiva, ku si objektivë kryesor kanë qenë të hyrat, gjatë auditimit kemi hasur në të gjeturat të cilat janë evidentuar në reportin final, janë dhënë katër rekomandime në bazë të planit të veprimit nga njësia e auditimit dhe nga drejtoria e inspektoratit kërkohet që të zbatohen këtë rekomandime. Ligji i auditimit të brendshëm thotë: Shqyrtimin e raporteve të njësisë së brendshme e bënë komiteti i auditimit dhe njësia qendrore harmonizuese përfshirë auditimit të brendshëm e MF, kuvendi nuk ka nevojë ta shqyrtojë reportin e njësisë së auditimit, komiteti i auditimit e shqyrton reportin e njësisë së auditimit të brendshëm pastaj ata dalim një raport të tyre, ku i raportojnë kryetarit të komunës dhe kuvendit.

Florije Boshnjaku – Falënderoj shefin e auditimit të brendshëm që na ka sjellë këtë raport, por desha të them që ky nuk është raporte por informatë, e them këtë sepse kuvendi ka të drejtë të kërkohë një informatë nga zyra e auditimit, ne edhe më herët kemi kërkuar nuk është hera e parë. Më vije keq që ky raporte ka shkuar në qendrën e auditimit të brendshëm sepse nuk dihet se përfshirë cilën periudhë është audituar ky raport dhe kur është kryer auditimi. Në faqe nr. 5 ceket: Grumbullimi i të hyrave vetanake nga ngarkesat kompensimet dhe taksat në shërbime përfshirë punë inspektuese përfshirë gjashëtë majoren e dytë të vitit 2017 dhe dy majoren e parë të vitit 2018. Pyetja ime përfshirë shefin e auditimit është se përfshirë cilën periudhë e ka kryer auditimin, po ashtu propozoj që të formohet komiteti i auditimit të brendshëm.

Hanalora Hoti – Pëershëndetje përfshirë gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem me këtë pikë të rendit të ditës, në rekomandimin nr.2 të këtij rapporti tek inspektorati i veterinarisë. Sot konsumatorët e komunës sonë janë të rezikuar skajshëm nga produktet e mishit, edhe sa kohë do të jetë në tryezat tona mishi i dyshuar, jam duke parë si konkluzione në këtë material por nuk jam duke e parë një plan konkret të implementimit përfshirë heqjen e kësaj dukuri negative.

Ali Zhuniqi – Jam kuvendar i ri dhe që tre raporte të auditimit që na vijnë në mbledhje të kuvendit, përvèç që kanë gabime drejtshkrimore asnjëri nga rekomandimet e punëve nuk ka tendencë ose trend të rritjes pozitive, përvèç rekomandime negative dhe ngecje të punës dhe personat që janë përgjegjës përfshirë kryerjen e punëve të tyre nuk e di pse janë duke i marrë ato paga dhe kur nuk e marrin përgjegjësin e tyre përfshirë vendin e punës, kur ne jemi duke parë që raportet e auditimit janë skandaloze.

Dervish Çadraku – Ne kemi diskutuar edhe në KPF përfshirë këtë çështje dhe është shumë e rëndësishme që ne të kemi informatën në lidhje me gjendjen se si qëndron brenda komunës, ne jemi pjesë e komunës dhe në një farë

mënyre kemi përgjegjësi edhe para qytetarëve. Nëse merremi konkretisht me këtë auditim dhe auditimet e tjera që i kemi pasur, e kemi thënë se këto auditime janë nga qeverisja e kaluar dhe neve tanë na mbetet vetëm që të marrim mend, po e them popullorë, pra të vetëdisohemi në mënyrë që mos të lejojmë që të ndodhin gabimet e tjera me qeverisjen e re. Sipas këtyre rekomandimeve na del që është një lloje trashëgimie e gabimeve që bëhen gjithnjë nga drejtorit e ndryshme dhe shkeljet e ndryshme sidomos kur bëhet fjalë për parat publike, aty pastaj nuk është blloku, ose nuk janë barazuar etj. Prandaj këtu ndoshta është e gjithë loja që bëhet tek keq menaxhimi i parasë publike, është mirë që të dimë më tepër për qeverisjen e re sepse ne nuk mundemi as të ndëshkojmë e as ta lavdërojmë për punën e bërë qeverisjen e kaluar. Ky raport ka shumë rëndësi për ju si menaxhues të komunës që ti evidentoni këto gabime, ose keqpërdorime që kanë ndodhur deri më tanë në mënyrë që mos të ndodhin më këto gabime, pastaj edhe ne si kuvendar do të kemi më pak punë që të ju kritikojmë.

Rasim Fazliu – Së pari e përshtendes kryetarin i cili na u bashkua në mbledhje, e kam thënë edhe, për raportet e tjera që është çështje humbje kohe sepse të gjitha rekomandimet që janë dhënë më parë nuk kemi ndonjë rezultat ose përgjigje se çka u bë me ato rekomandime, ne mundemi ta shqyrtojmë por siç e thash ka pak efekte, prandaj më mirë ndoshta do të ishte të fokusohemi në punën e qeverisjes së tanishme pa dashur me e tejkalu se çka ka qen e kaluara. Ne e dimë se roli i Komitetit të auditimit është rolë këshillues si për qeverisjen komunale ashtu edhe për ne që mos të na lejojë me bë lëshime, falënderoj shefin zyrës së auditmit që na ka sjellë këtë raport, po ashtu mbessë me shpresë se këto raporte do na sillen vazhdimisht edhe nga qeverisja aktuale, jam duke biseduar pa kurrfarë tendencë por me qëllime shumë të mira, në mënyrë që të shikojmë se si janë duke u zhvilluar ngjarjet.

Fehmi Cena – Sido që do ta quajmë këtë raport apo informatë, këtu janë disa të dhëna që neve na jepet qasja në lidhje me punën e Drejtorisë së Inspektoratit, këtu janë të paraqitura mjaftë të gjetura të parregullta si rrëth buxhetit ceket p.sh si planifikimi dhe realizimi kanë një diskripancë shumë të madhe, pra më pak të hyra se sa planifikimi. Pastaj përmendet degradimi i tokës bujqësore, kjo më ka ra në sy më së shumti sepse me të vërtet në komunën tonë është duke u degraduar çdo ditë toka bujqësore, ndërtimet e objekteve të ndryshme kurse ne llogaritemi si komunë bujqësore dhe veprimtarin kryesor për ekzistencën familjare pikërisht e kemi bujqësinë. Prandaj mendoj se komuna dhe qeveria komunale duhet që të ketë këtë parasysh, angazhimin që ta mbrojë tokën bujqësore, bie në sy rrafshi poshtë ku ekziston edhe komasacioni, dëmtimi i asaj toke është diçka që neve do na dëmtojë sot dhe shumë kohë në të ardhmen. Përndryshe rekomandimet duhet që të zbatohen në mënyrë që të punohet më shumë, puna e inspektoratit ka ndikim të drejtpërsëdrejti edhe në të hyrat komunale, por njëkohësisht edhe në zbatueshmërinë e ligjshmërisë si të personave fizik ashtu edhe të personave juridik.

Kryetari – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, ju siguroj jo vetëm për hir të transparencës i cili është obligim si moral ashtu edhe institucionalë, por përfaktin që ne kemi edhe obligim ligjor, që ti dërgojmë raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm kuvendorit komunal, ata që janë me përvojë besoj se e dinë që ne nuk mundemi që ti kemi shpejtë ato sepse edhe auditimi i brendshëm edhe i jashtëm e ka një plan pune, nëse raportet ishin bërë sot për sot atëherë na kishin ndihmuar edhe neve si qeveri lokale dhe i kish dhënë mundësi kuvendorit të komunës me qen një mekanizëm i cili e korrigjon dhe e përmirëson punën qeverisjes. Këto punë të nderuar kuvendarë nuk bëhen shpejtë sepse ka një plan ku bazohen edhe këta në ligj dhe zakonisht raportet e aludimit të brendshëm ose të jashtëm vinë një vite më vonë. Ju premtoj publikisht juve sot se çdo dokument që ka të bëjë me auditimin dhe çdo dokument që sipas ligjit obligohemi për transparencë dhe përfundim sot se debatuar në kuvendorin e komunës do ta keni me kohë. Kurse sa i takon rekomandimeve natyrisht se është në përgjegjësin e një qeverie që ti adresoj rekomandimet në bazë të një plani veprues dhe të mos përsëriten gabimet nëse janë të vazhdueshme, sa përlustrim për herë të parë në komunën tonë janë regjistruar këtë vite asetet jo financiare, shpresoj se as auditori i brendshëm e as auditori i jashtëm nuk do të shigjetoj komunën e Rahovecit si një komunë që nuk e ka bërë regjistrimin e aseteve jo financiare. Na është dashur 4 muaj, kemi formuar disa komisione deri sa kemi ardhur në përfundim të regjistrimit të asetëve jo financiare. Nuk është çështja që ti kritikojmë qeverisjet e kaluara, por çështja është ashtu siç e tha edhe kuvendori z. Rasim Fazliu që nga raportet e auditimit të cilët kanë qëllim edhe për këshillë dhënie edhe ndihmë, ne tanë do ta aktivizojmë edhe komitetin e auditimit të brendshëm që edhe ky komitet i cili është formuar nga të gjitha qeveritë por i cili ka qen pasivë, neve na mbetet sfidë e madhe për me

aktivizua komitetin e brendshëm si mekanizëm që e përmirëson në vazhdimësi punën tonë si qeverisje dhe ato raporte që ju vinë pastaj në kuvend me siguri ju si kuvendarë do të keni më pak hapësirë për me bë kritika.

Kryesuesi – Nëse nuk ka askush më të shtoj diçka sa i përket kësaj pike, ju falënderojmë për diskutimin e bërë. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

6. Informatë rreth sigurisë në shkollat e Komunës së Rahovecit.

Avni Morina – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, e kam përgatitur një informatë për sigurinë në shkollat e komunës së Rahovecit dhe është siç në vijim: Që nga fillimi kur unë jam emëruar në detyrën e drejtorit të Drejtorisë Komunale për Arsim, jam përkushtuar që punët në këtë sektor mjaft të rëndësishëm të fillojnë të ecin mbarë. Fillimisht, kam mbajtur takimin e parë me drejtorët e të gjitha shkollave dhe gjëja e parë që kam kërkuar nga ta është respektimi i orarit të punës, në radhë të parë nga drejtorët e shkollave, e pastaj edhe nga mësimdhënësit dhe edukatorët. Siguria në shkolla është një çështje e rëndësishme që duhet trajtuar. Kjo çështje është e lidhur ngushtë me vijueshmërinë e nxënësve në shkolla. Nxënësit tanë, e sidomos ata të klasave të larta dhe të shkollave të mesme të larta, në qoftë se nuk vijojnë mësimin rregullisht janë të ekspozuar ndaj dukurive negative me të cilat mund të përballen jashtë hapësirave shkollore. Në shkollat filllore dhe të mesme të komunës sonë, sipas shënimive më të fundit që disponojmë kemi 10625 nxënës. Në fund të gjysmë vjetorit të parë të këtij viti shkollor kemi marrë statistika e fundit për numrin e mungesave dhe vijueshmërinë e nxënësve dhe mësimdhënësve. Nga këto të dhëna, është vënë re se vijueshmëria e nxënësve, sidomos në klasat e larta dhe në Shkollat e Mesme të Larta është nën çdo nivel. Për këtë arsy, DKA ka filluar të marrë masat e duhura administrative, duke u bazuar edhe në rregulloret dhe udhëzimet administrative. Kemi formuar një komision të veçantë për verifikimin dhe evidentimin e mungesave të nxënësve dhe mësimdhënësve nëpër 3 SHML – të dhe në SHMLP. Komisioni ka kryer punën për të cilën është ngarkuar dhe ka hartuar një raport detal të vijueshmërisë së nxënësve dhe mësimdhënësve. Pasi kemi analizuar këtë raport, kemi ndërmarrë masa për të përmirësuar gjendjen e sigurisë dhe për të rritur vijueshmërinë në procesin edukativo-arsimor. Përveç këtyre veprimeve, ne kemi analizuar gjendjen e sigurisë në shkolla edhe në debatin e organizuar nga DKA, në bashkëpunim me Qendrën Rinore SHHL- Kosova, me Shërbimin Policor të Kosovës, DKRS-në, me njohës të fushës së arsimit, me Këshillat e Prindërve dhe Këshillat e nxënësve. Nga ky debat dhe nga angazhimet e drejtپerdrejta me drejtuesit e shkollave, ne kemi nxjerrë disa rekomandime ku pretendojmë të i shndërrojmë në rregullore pune nga 1 shtatori i vitit 2018, disa nga rekomandimet që i kemi nxjerrë nga debatet e vazhdueshme janë këto: Të shtohet prezenca e policisë në rrugët pranë objekteve shkollore, sidomos në kohën e drekës dhe në mbrëmje, kur mbaron ndërrimi i parades, respektivisht i pasdites, të shtohet kontrolli i inspektoratit dhe polisës në lokallet hoteliere pranë shkollave, të shqyrtohet mundësia e angazhimit të sigurimit privat dhe vendosja e kamerave në shkolla, të rritet komunikimi ndërmjet mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, të rritet performanca e mësimdhënësve në mësim, angazhimi i pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, organizimi i debateve dhe ofrimi i ndihmës/këshillave nxënësve që kanë nevojë, përmirësimi i infrastrukturës shkollore (banka, karrige, mjete konkretizimi), organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore për edukimin e të rinjve/socializimi, eliminimi i konsumimit të duhanit, alkoolit dhe eventualisht substancave narkotike në hapësirat shkollore, kodi i veshjes në shkolla (të vlefjë për nxënës dhe mësimdhënës), takime të rregullta (obliguese) të këshillit të shkollave, këshillit të prindërve dhe nxënësve, të rritet niveli i higjenës në shkolla, mospërdorimi i telefonave gjatë kohës së mësimit (të vlefjë për nxënës dhe mësimdhënës), angazhimi periodik i ekspertëve të jashtëm. Me zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe me harmonizimin e tyre me udhëzimet administrative të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, synojmë që të përmirësojmë jo vetëm gjendjen e sigurisë në shkolla, por edhe të rrisim cilësinë e arsimit në komunën tonë. Për t'i arritur këto synime të nderuar kuvendarë, nevojitet një angazhim, përkushtim dhe koordinim i gjithmbarshëm i të gjithë neve.

Mirjeta Krasniqi – Falënderojmë drejtorin e nderuar për këtë informatë, këto rekomandime që i potencoi drejtori ne i përkrahim të gjitha dhe urojë që të bëhen rregullore për vitin e ardhshëm, por unë desha të ndërlidhem në disa çështje, i nderuari drejtori ju keni cekur se janë mbajtur gara diturie në kohën kur e keni përpiluar këtë report besoj, por ndoshta janë mbajtur garat edhe pas përpilimit të këtij reporti. Pyetje ime është a keni paraparë ndonjë mënyrë stimuluese për nxënësit që kanë arritur të i marrin vendet e para, mendoj se do të

ishte mirë si DKA të organizonit ndonjë ekskursion në nivel komunal, ku do i kishit mbledhur nxënësit që i kanë zënë vendet e para në të gjitha shkollat ose të i ndahet ndonjë dhuratë simbolike dhe në këtë mënyrë besoj se do të ishte stimuluar më shumë konkurenca për gara për dituri. Sa i përket mungesave jemi duke parë që kemi mungesa të mëdha në shkollat e mesme, ku si masë ndëshkuese kanë marrë edhe pezullimin dhe transferimin e nxënësve në një shkollë tjeter, por pyetje ime është: Sa ka ndikuar kjo praktik, por unë i kam parë që ata që shkonin nga Rahoveci në Ratkoc i humbnin nga dy orët e para dhe të fundit për shkak të transportit. Desha edhe një informatë shtesë për shkollën "Milaim Krasniqi" a është në projektin në kuadër të eficiencës apo nuk është pasi që në mbledhjen e kaluar kryetari na ka informuar që është, por unë kam një dilemë pasi që në biseda që kam bërë paraprake me drejtorin e DKA-së më ka thënë që nuk është, e vetmja shkollë është e Drenocit. Nëse nuk është a keni kërkuar nga ministria që të ndërmirën masa pasi që kushtet janë minimale për të mbajtur procesin mësimor.

Fahrije Lushi Morina – Përvendetje për të gjithë të pranishmit, ne edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar, por edhe sot para të gjithë juve ju drejtoshem prof. z. Avni Morinës duke i thënë se i keni përmend të gjitha pikat apo dukurit të cilat do i vendosnin një pasqyrë më të arsyeshme, por duke mare parasysh numrin e madh të mungesave nga nxënësit, a mendoni se kjo sjellë një imazh të mirë apo sjellë ndonjë imazhe krejt ndryshe. Jo që nuk më bëjnë përshtypje rekondimet, mirëpo cilësia në arsim ritet ose arrihet atëherë kur ky numër i mungesave do të jetë më shumë i arsyeshëm, rekondimet lidhen me të gjitha dukuritë që i duhen shkollave, por sa janë duke u ndërmarrë këto masa apo këto rekondime. Në momentin që ju i keni paraparë të gjitha këto rekondime a mendoni se do të realizoni në një periudhë të një afati sa më të shkurtë, që thjeshtë të marrim një imazh pak më ndryshe si me mungesat ashtu edhe me pasqyrën ngritjes së nivelit të vetëdijes dhe ngritjes së nivelit të arsimit brenda komunës sonë.

Munib Durguti – Me vëmendje e kam përcjellë informatën të cilën e ka sjellë drejtori i DKA-së në Kuvend, e përgëzoj për punën që e ka bërë në këto muajt e parë të mandatit, të gjitha këto të gjetura do të thuaja që një pjesë e tyre është në kompetencë të drejtorisë së arsimit, besoj se drejtoria e DKA-së duhet që të hartoje një plan konkret për zbatimin e këtyre të gjeturave. Jemi duke parë p.sh në këtë raport që kemi mungesë të kamerave nëpër shkolla, mungesë të ndriçimit në disa lokacione, pastaj probleme me hoteleri që janë shumë pranë shkollave të cilët që nga ora shtatë e mëngjesit lëshojnë muzikë ku u hamendin nxënësit, mendoj se një koordinim me policin dhe profesorët do të eliminoheshin këto dukuri. Po ashtu mos përdorimi i telefonave, takimet periodike e kështu me radhë, të gjitha këto do të ishte mirë që të janë pjesë e një plani të veprimit konkret me afate në mënyrë që pas një kohe të mos jetë prapë temë e debatit në kuvend.

Florije Boshnjaku – Falënderoj drejtorin e DKA-së, po ashtu e përgëzojë për punën që është duke e bërë, po ashtu edhe unë plotësisht pajtohem që është mirë që të ketë qeveria komunale, në këtë rast DKA-ja një plan të veprimit për zbatimin e këtyre rekondimeve. Për zbatimin e këtyre rekondimeve na duhet ndihmesa e të gjithëve si mësimdhënësve, prindërve, nxënësve, anëtarëve të kuvendit, pra secili në mënyrën e vetë të jep kontributin në mënyrë që të dalim nga kjo situatë. Mënyra se si me u zgjidhë kjo, në bisedë me njerëzit profesionistë në këtë lami është: jemi duke parë që kemi mungesa të mëdha, pastaj kemi fëmijë me sjellje asociale, sipas tyre duhet që të kemi pedagog dhe psikolog nëpër shkolla, së paku të i kemi 5 pedagog nëpër shkollat e komunës sonë, ata kishin për ti ndihmuar shumë drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve. Mundësish në të ardhmen ose me Caritasin ose të gjendet një mënyrë tjeter që të punësohen disa pedagog dhe psikolog në shkollat e komunës sonë.

Ali Zhuniqi – Përderisa drejtori i DKA-së i quajti këto rekondime, unë të gjitha këto pika jam duke i parë që janë shumë problematike dhe për këtë nuk jam duke e fajësuar drejtorin aktual i cili shumë mirë ka bërë që i ka cekë këto pika të cilat janë mjaftë problematike, por kjo është nga akumulimi i problemeve nga qeverisja e kaluar duke e përfshirë edhe kryetarin aktual i cili e ka pasur edhe një mandat në të kaluarën. Pra çështja e mungesave të paarsyeshme është akumuluar si pasojë e mos punës së drejtorive komunale nga qeverisjet e kaluara, mendoj se po aq kohë sa është dashur që të vihet deri tek një problem i tillë, na duhet po aq kohë që të shkojë që të eliminohen këto lloje probleme. Paramendoni ka ardhur puna që edhe policin ta dërgojmë nëpër kafiteri që të i thonë nxënësve që të shkojnë në shkollë, kjo është përtej nivelit të arsimit dhe kjo ndodhë për arsyen se partite

politike punësojnë në mënyrë klientiliste si familjarë, aktivistë ose të afërt të ndonjë bashkë partiaku. Njëra nga pikët që e përgëzojë drejtorin është: Angazhimi i pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla, kjo është pikë kyçë dhe kryesore në një farë forme që kishte mundur të i ndihmojë jashtëzakonisht shumë nxënësve, po ashtu këta psikolog kishte me qen mirë që të bisedojnë edhe me drejtorë të shkollave sepse me të vërtet nuk janë në tok të bukës. Më vije shumë keq kur e pashë se me një mesatare prej 28 mungesave të arsyeshme dhe të pa arsyeshme për një gjysmë vjetor për një nxënës, kurse në total janë mungesa 64360 mungesa, pra kjo është nën nivelin e gjithçkaje. E kem një pyetje për drejtorin e DKA-së, e ka cekur angazhimin e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, por nuk ka cekë data, meqenëse gjendja është jashtëzakonisht alarmante duke pas parasysh numrin e madhe të mungesave, mendoj se duhet që të na jepni data konkrete se kur do të janë të angazhuar pedagogët dhe psikologët nëpër shkolla, mendoj se kishte me qen mirë që sa ma shpejtë që është e mundur që të angazhohen pedagogët dhe psikologët në shkolla, po ashtu duhet që të merën masa sa ma shpejtë nga ana e drejtorëve të shkollave që të zbuten masat e mungesave. Për nivelin e mësimdhënësve nuk dua të flas sepse kam dijeni që ka mësimdhënës që shkojnë për të dhënë mësim dy orë dhe e marrin pagën e plotë, arsyja se kanë që të shkojnë të i punojnë tokat e tyre, mos të bëhem naiv, ne e dimë që jemi teren bujqësor. Pastaj këtu ceket përdorimi i telefonave nga ana e nxënësve, kurse unë e them që bëhet e kundërtë sepse përdorimi i telefonave bëhet nga ana e mësimdhënësve dhe cili në rastin konkret duhet të jetë shembulli, drejtori shumë mirë i ka dhënë rekomandimet por nuk ka dhënë zgjidhje të problemeve. Mendoj se duhet që të japim kohë drejtorit të DKA-së, por me të gjitha këto probleme as ministri i arsimit nuk do të kishte mundur me i zgjidhë.

Rexhep Oruçi – Këtë informatë e kam lexuar me shumë vëmendje, e cila titullohet: Informatë rrëth sigurisë në shkollat e Komunës së Rahovecit, por sa jam duke parë këtu më së paku bëhet fjalë për siguri, kurse më shumë bëhet fjalë për preventivë siç janë performanca, angazhimi i pedagogëve etj. sa i përket këtij raporti unë e kisha ndarë çështjen e sigurisë në shkolla në dy segmente e ato janë: Sigurimi i jashtëm, i cili varet nga faktorët e jashtëm si nga policia e Kosovës dhe nga sigurimi i brendshëm që varet nga faktori arsimor, personelit të shkollave dhe normalisht nga DKA-ja. Do fokusohem pak në çështjen e sigurisë së jashtme, jam duke folur nga përvoja sepse jo shumë larg kemi pasur shumë incidente, si sulme fizike nëpër shkolla e ne veçanti në shkollat e mesme nga personat e papërgjegjshëm, qytetarët e papërgjegjshëm. Sigurisht kur është influenca më e madhe e nxënësve është në mes të dy ndërrimeve, dalin disa persona me automjete ku provokojnë nxënësit e në veçanti ato të gjinisë femërore, kemi pasur shumë raste si të sulmeve fizike, përleshje, lëndime etj. prandaj kisha bërë apel tek drejtoria e DKA-së që ti drejtohet shërbimit policor me një shkresë zyrtare, që të kërkoj në veçanti që në mes të dy ndërrimeve të jetë prezencia e policisë, besoj se nuk është problem sepse janë diku 3-4 qendra shkolllore dhe për gjysmë ore kryhet, vetë prezanca e tyre ndikon pozitivisht në sigurinë e faktorit të jashtëm.

Besmire Bytyqi – Së pari e falënderoj drejtorin e DKA-së për këto informacione që na ka sjellë, i kam përcjellë të gjitha debatet që janë organizuar nga DKA-ja në bashkëpunim me SHL-Kosova. Pas daljes së këtyre rekomandimeve është formuar një komision sipas informacioneve që i kam, më vije shumë keq që nuk ka të dhëna rrëth përbërjes së këtij komisioni, personalisht dua ta di se si do të bëhet themelimi i këtij komisioni, kush do të jetë pjesë e këtij komisioni dhe ndoshta një zotim nga Kryetari i Komunës dhe DKA-ja, që të gjitha këto mungesa dhe të gjitha këto probleme që i kemi të largohen sa më shpejtë dhe të mënjanohen.

Qazim Qeska – E përkrahi plotësisht informatën e drejtorit të nderuar, i nderuari z. Rexhep Oruçi e preku çështjen të cilën desha ta ngrisë, së pari si prind sepse kam fëmijë në shkollë të mesme, por edhe si qytetar dhe kuvendar do të doja nga drejtori i nderuar që të di nga retrospektiva e tije 4-5 mujore që është drejtor i DKA-së, të na tregoj në mënyrë përmbytjesore, ngase nga kjo informatë unë si qytetar nuk kam mundur të kuptoj se cila është gjendja e sigurisë në shkollat tona. Në paragrafin e parafundit të informatës shumë mirë është e cekur se të gjitha këto rekomandime do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së sigurisë. I nderuari drejtor jeni personi i dytë pas kryetarit të komunës përgjegjës për arsimin, dua nga ti se çfarë është gjendja e sigurisë në shkollat tona.

Rasim Fazliu – Falënderoj drejtorin për këtë informatë që na ka sjellë, por mendoj se titullit është dashur jetë: Informatë rrëth sigurisë dhe aktiviteteve të zhvilluar në shkollat e komunës së Rahovecit sepse këtu janë të përshkruar edhe aktivitetet e jo vetëm siguria. Është shqetësues me të vërtet numri i madhe i mungesave në të gjitha nivelet e shkollave të Komunës sonë dhe kjo duhet që të na shqetësoj të gjithëve, por mendoj se drejtori i

DKA-së nuk ka mundësi të gjitha vetë të i zgjidhë nëse nuk angazhohemi edhe ne të gjithë, duke filluar si familje, ne si anëtar të kuvendit etj, në mënyrë që sa më pak të ketë probleme në shkollat tona. Më vije mirë që është formuar komisioni për shqyrtimin e këtyre rekomandimeve, por duhet të shikohet se sa do të mundemi që ti zbatojmë këto rekomandime, por siç e cekë për këtë duhet angazhim i të gjithëve. Ajo që desha të ceki unë është: Kishte me qen mirë që në nivel të gjitha shkollave tona të evidentohen nxënësit me nevoja të veçanta dhe kjo të shkojë përmes drejtoreve të shkollave, po ashtu pastaj të formohen klasë të veçanta për ata nxënës edhe pse në ligjin e arsimit ceket se nxënësit me nevoja të veçanta duhet që të rinë me nxënës që janë në rregull për arsy që të socializohen edhe ata, por unë jam duke folur nga praktika, më besoni se një nxënës me nevoja të veçanta që më vije shumë keq që po e them sepse zoti i ka krijuar ashtu, por aq shumë krijon në klasë parregullsi dhe nuk mundesh të punosh me nxënës të tjerë sepse ai pengon në zhvillimin e aktivitetit mësimor. Ne një nxënësi mundohemi që ti ndihmojmë por 29 të tjerë i humbim, e di që ka klasë të veçanta në komunën tonë që janë funksionale por jo të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta janë të përfshirë në këto klasa, ndoshta këtu mungon edhe interesimi i prindërve, por ne duhet që të interesohemi që të janë këta në klasa të veçanta. Kemi biseduar edhe në KPF dhe ne i dimë shumë mirë mundësit buxhetore të komunës së Rahovecit, por pasi jemi duke pretenduar që të shkojmë ka përmirësimi i cilësisë në arsim, do të ishte mirë që brenda mundësive buxhetore që ti punësojmë edhe disa psikolog dhe pedagog të cilët do të mirën vetëm me këto çështje dhe ata të janë lëvizës e jo të janë të punësuar vetëm për një shkollë, por aty ku është nevoja të shkojnë të punojnë me nxënës që kanë nevojë për ata.

Florida Bajraktari – I pasi disa rekomandime të rëndësishme në këtë raport për përmirësimin e gjendjes e sigurisë në shkolla, do të ndalem pak të diskutoj rreth rekomandimit me nr.4, kërkesa ime është që të ritet sa më shumë komunikimi në mes mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, pra të funksionoj sa ma mirë ky trekëndësh. Shumica e prindërve e dinë që i kanë dërguar fëmijët në shkollë për tu arsimuar, ndërsa shumica prej tyre mungojnë në shkolla, kjo na vërteton edhe numri i madh i mungesave.

Dervish Çadraku – Kjo informatë sa është interesante është po aq e dhimbshme duke parë problematikat që i ka arsimi ynë sot, të ju themi të drejtën ne si qytetar e kemi ditur përafërsisht se si është gjendja në arsim sepse këtë më mirë na ka treguar edhe testi i PISAS. Tani e kemi problemin e lokalizimit të problemeve në komunën tonë, këto probleme të cilat i paraqiti drejtori nuk janë probleme të sodit, këto janë probleme të kamotshme dhe këto probleme nuk ka mundësi të i rregulloj drejtori edhe po të ishte ku ta di kush. Për këtë jemi përgjegjës e tërë shoqëria duke filluar nga nxënësi, prindi dhe faktorët e tjerë të familjes në mënyrë që të funksionoj më mirë trekëndëshi shkollë, nxënës, prind, pa funksionimin e këtij trekëndëshi është shumë problem me pas rezultat. Sa për kureshtje e bëra një kalkulum matematikor, nëse viti shkollor i ka nëntë muaj mësim dhe një muaj i ka 30 ditë atëherë na del që arsimi i mësim i kemi 270 ditë në vit, këto 270 ditë i shumëzojmë për 6 orë në ditë na dalin 1620 orë mësim, dhe nëse këtë 1620 orë i pjesëtojmë me 9516 mungesa na dalin hiq më pak se 30.5 vjet humbje. Pra ne i kemi humbur 30 vite me këto mungesa. Që është më keq në shkollën e mesme i kemi 64360 na del diku 39.7 vite të humbura, pyetje ime për drejtorin është a ka pasur masa disiplinore për këta nxënës të cilët kanë munguar sepse sa e di nëse një nxënës i bënë 30 mungesa të pa arsyeshme fillon masa disiplinore sepse këto janë masa të cilat nxënësin e vetëdijesojnë. Po ashtu është mirë që kujdestari të i ketë numrat e secilit prind në mënyre që së paku ai të ketë 2-3 herë në vit komunikim me ta dhe atëherë ai mësimdhënës e ka gjendjen shumë të pastër me prindërit e nxënësve ose prindërit të thërrasin mësimdhënësin, kështu funksionon në perëndim. Kur bëhet fjalë për rekomandimet, mendoj se rekomandimet ishin shumë të mira, por këto rekomandime nuk janë vetëm nga sot, ne kemi pasur rekomandime edhe nga qeveritë e kaluar, por i gjithë problemi qëndron tek implementimi dhe realizimi i këtyre rekomandimeve, nëse këto rekomandime implementohen besoj se do të ketë përmirësimë në arsim. Uroj që në të ardhmen të ndërgjegjësohemi edhe ne si shoqëri dhe të bashkëpunojmë me shkollën sepse shkolla është shtylla e kombit, nëse këtë e lëmë ende të çalojë atëherë edhe kombi do të çalon.

Fehmi Cena – Mendoj se ky është një raporte i shkurtë por mjaftë i kuptueshëm dhe mjaftë gjithëpërfshirës, gjërat në arsim janë gjërat që ne i njohim. Ajo që të bije në sy e thanë edhe parafolësit, është numri i madh i mungesave edhe pse ne pak a shumë e kemi ditur se nxënësit tanë janë duke bërë shumë mungesa sepse të gjithë kemi fëmijë në shkolla, ajo që na ka ra në sy është frekuentimi i madh i nxënësve përreth shkollave, sheshe,

rrugë, lokale etj, na lë të kuptojmë se ata nuk janë në orë të mësimit, ku kjo pastaj ndikon drejtpërsëdrejti në suksesin e tyre. Sa i përket këtyre lokaleve që gjenden përreth shkollave kam dëgjuar se janë të mësimdhënësve, pastaj organizojnë disa ahengje ku i thërrasin nxënësit, janë disa dukuri që mua si qytetar dhe prind nuk më pëlqejnë dhe kjo mendoj se i bie edhe konflikt interesit. Kurse sa i përket rekomandimeve që janë cekur në këtë informatë, mendoj se janë të mira dhe gjithëpërfshirëse dhe ku me pas mundësi që të realizohen, nuk do të shkojë me radhë por do i ceki dy ose tre më të rëndësishme. Angazhimi i pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla edhe pse u tha nga parafolësit, mendoj se ka ardhur koha me të vërtet që të punohet në këtë drejtim, ku besoj se ata do të japid atë ndikimin e tyre pozitiv. Pastaj rekomandimi tjetër është eliminimi i konsumimit të duhanit dhe alkoolit dhe veseve të këqija si dhe substancave narkotike, mendoj se kjo është bërë edhe në të kaluarën por mendoj se duhet që të jepet rëndësi më shumë në këtë rast nga DKA-ja në bashkëpunim me DSHMS, sepse këtu kërkohet profesionistë, dhe shëndetësia ka profesionistë, të mbahen ligjëratat, debate, dhe në këtë mënyrë të ngritët vetëdija e qytetarëve në përgjithësi, por sidomos e nxënësve që të i shmanget këtyre dukurive sepse kjo është një betejë serioze për të ardhmen tonë. Tek rekomandimi që të ritet niveli i higjenës në shkolla, për këtë kisha potencuar sidomos tek nyet sanitare, ne jemi prindër dhe vetë kam shkuar në disa shkolla, në disa shkolla nyejt sanitare nuk janë në gjendje të mirë, ato nëse nuk kanë ujë janë të papërdorshme dhe duhet që të mbyllët. Ajo mundet të shërbej si burim i infeksionit dhe i epidemive, ne në çdo verë kemi epidemi me barkë qitje, prandaj duhet që të kemi kujdes edhe nëpër shkolla sepse aty është frekuentimi i madh dhe ekziston mundësia e shpërthimit të epidemisë, pra investimi le të bëhet në këtë drejtim qoftë financiar qoftë rrëth mirëmbajtjes së tyre.

Kryetari – Natyrish se është sfidë e drejtpërsëdrejti e drejtorit të DKA-së, por unë do të flasë në vija të trasha parimore për disa çështje që u ngritën. Personalisht kam mare pjesë në dy takime të jashtëzakonshme që janë organizuar në shkollat e mesme të Rahovecit, në këto takime tema qendrore ka qen çështja e mungesave, që me seriozitetin më të lartë është trajtuar. U përmend këtu çështja e transferit ose masave edukative korrektuese të nxënësve të cilët mungojnë, ne nëse e bëjmë një matematik atëherë ne duhet që nxënësit e dy shkollave të mesme në Rahovec me i bartë në Ratkoc ose Krushe të Madhe dhe nxënësit e Ratkocit dhe Krushës me i sjellë në Rahovec, sepse secili nxënës mesatarisht i plotëson kushtet për transferim, masa e transferimit në një gjendje kaq shqetësues nuk e besoj se ka prodhuar ndonjë rezultat edhe pse është aplikuar edhe në të kaluarën. Gjatë këtyre dy takimeve të jashtëzakonshme kam vërejtur dy situata, një situatë kur një mësimdhënësse thotë në klasën time nuk kam asnjë mungesa të nxënësve, kjo ka ndodhur në shkollën e mesme profesionale, kurse në situatën tjetër në përgjithësi nga të gjithë kujdestarët e klasave ku thonë se kemi me qindra mungesa nga nxënësit. Pra nëse paska mundësi një mësimdhënësse me e gjete modalitetin dhe të tregoj shembullin e mirë se si munden të ndalen mungesat e nxënësve, atëherë mendoj se sigurisht se duhet që të kërkohet në kuadër të planit të veprimit. Plani veprues për zbatimin e rekomandimeve që ndoshta për herë të parë i vijnë në të shkruar kështu kuvendorit, nënkupton forcimin e institucionit të drejtorit të shkollës, i cili është përgjegjësi nr.I në shkollën ku i ka përgjegjësit dhe detyrat e veta, të përcaktuara me ligj dhe udhëzim administrativ. Fuqizimi i rolit të organeve të shkollës janë: Këshilli i prindërve, këshilli i klasës dhe plotë organe të tjera që kryesisht janë jofunksionale si në shkollat e mesme ashtu edhe në shkollat filllore. Pastaj qartësimi i detyrave të përgjegjësve të tjerë të shkollës, ata të cilët merën me mirëmbajtjen e shkollës, higjenën e shkollës etj. për këtë nuk ka nevojë fare të lexohet udhëzimi administrativ dhe as ligjet, sepse nëse dikush paguhet nga buxheti i shtetit duhet të dijë vërtet se si duhet të mirëmbahet WC e shkollës, ne kemi problem me mosrealizimin e detyrave nga ata që i kanë përgjegjësi për me i krye detyrat e veta dhe në rastin konkret nga drejtori, zëvendësdrejtori dhe mekanizmat e tjerë të organizuar të shkollës. Ne do të insistojmë që nga 1 shtatori që rregulloret aktuale që janë në fuqi dhe kodi etik të respektohen maksimalisht nëse jo do të ketë sanksione. Dikush shtroi çështjen se a janë mëra masa disiplinore ndaj dikujt, po të nderuar ka mëditje që ju ndalen mësimdhënësve, pastaj a ka klientel në shkollat tona, por gjithsesi se ka, bile nga të gjitha parti, por ka edhe nga ata që janë pa parti. Nuk ka parti që nuk i ka simpatizant e vetë të përfshirë në procesin edukativo arsimorë, qoftë në shkollat filllore, qoftë në shkollat e mesme dhe kjo mendoj se nuk ka asgjë të keqe dhe kjo nuk e pengon asnjë shkollë që ata të i kryejnë detyrat e veta. Ne jemi kundër politizimit të shkollave, pas orarit të mësimit ku të duanë le të shkojnë sepse ata kanë të drejtë të përcaktohen dhe të zgjedhin cilin donë subjekt politik, ne do ti fuqizojmë masat dhe do të sigurohem bashkërisht

me ju që rregulloret të cilat janë në fuqi të zbatohen sepse kjo punë nuk mundet të kryhet vetëm. Sa i përket informatës që e keni para vete edhe unë kam qen në dilemë a me qit në kuvendin e komunës sepse dikush mundet me e hapë debatin e madh se a është mirë me pas shkollat e mesme në komunën e Rahovecit apo në Kosovë sepse me të vërtet është një numër tepër i madh i mungesave dhe deri më tani nuk kemi mundur me e gjete ilaqin e zvogëlimit të mungesave. Por ne ju kemi sjellë këtë informatë e cila është shumë reale e cila përshkruan gjendjen faktike në detale, ne kemi raste ndoshta që duhet të informohet edhe prokuroria, kemi raste kur deformohet nota, pastaj arsyetohet mungesa, pastaj bëhen shumë falsifikime etj. Sa i përket punësimit të pedagogëve dhe psikologëve ju e dini se komuna e Rahovecit nuk ka mundësi buxhetore, kam tentuar që ti punësoj me Caritas Kosova por përsëri nuk kemi pasur mundësi sepse duhet që të planifikohet, por ndoshta edhe të gjenden mekanizma partner siç është Caritas Kosova ashtu siç ja ka bërë Komuna e Suharekës, për me i angazhues pedagogët dhe psikologët nëse kanë nevojë.

Refki Kryeziu – Pasi që është kryetari këtu prezent kam një pyetje rrëth arsimit pasi edhe punoj në këtë institucion. I nderuari Kryetar ju besoj jeni në dijeni rrëth gjendjes së sallës së edukatës fizike në shkollën “Selajdin Muallabazi –Mici” nuk është në një gjendje të mirë pasi është prishur parketi, a keni ju si ekzekutiv ndonjë plan përrregullim të kësaj sallë.

Kryetari – Në këtë sallë ka ndodhur një avari e cila ka ardhur si rezultat i asaj që e thash pak më parë, nuk e di a kanë përgjegjësi ata që duhet të i kryejnë punët e veta, ka mjaftuar që dikush ta harroj ose me e lënë me qëllim ujin që të shkojë dhe të shkaktojë atë që e tha i nderuari kuvendar. Me marrjen e mandatit si kryetar e kam formuar një komision ku e kem dërguar që të shikojnë gjendjen, por nuk i kam besuar kam thanë se është duke luajtur me ne sepse ata më kanë thënë se dëmtimi është diku në vlerë prej 50,000.00 €. Pastaj e kam dërguar edhe një komision tjetër sepse nuk i kam besuar të parit, por edhe ky komision më ka vërtetuar se situata ashtu qëndron siç ka thanë komisioni i parë, ne tani si komunë nuk kemi mjete të planifikuara që ta sanojmë këtë defekt, por nëse më pyet mua tani dikush se çfarë masa janë marr ndaj atyre që kanë përgjegjësi, ndoshta kjo ka qen preteksti që i kam thirrur në takime të jashtëzakonshme të gjitha shkollat e mesme, në mënyrë që të sqarojmë këto situata. Sepse besoj se për këtë nuk është fajtor as kryetari e as drejtori i DKA-së dhe as ju nëse dikush që e ka për detyrë me e mbajt sallën nuk ka shkuar me e krye punën e ve dhe ky dikushi i ka shkaktuar dëme buxhetit të komunës së Rahovecit diku 50,000.00 €. Pse ne nuk e kemi një situatë të tillë në një shkollë tjetër ose ambulant, pse kur shkojmë në atë shkollë dhe në atë ambulant të bije madhi që të flesh aty nga pastërtia, kurse në shkollat dhe ambulancat e tjera nuk kemi këso situata, pra duhet që të ketë një dashur ndaj institucionit ku punon dhe je përgjegjës.

Refki Kryeziu – I nderuari kryetar nuk e di sa jeni të informuar, por në këtë sallë stërvitur edhe KB Rahoveci dhe gjatë natës ka ndodhur një pëlcitje e ujit i cili e ka prishur parketin. Ne disa profesor i kemi pyetur disa mjeshtër privatë të cilët mirën me këto punë se sa mundet të kushtoj rregullimi i asaj pjese, sipas tyre kjo mundet të kushtoj 2500 – 3000 €, nuk ka nevojë të ndërrrohet parketi sepse ai është i ri, ai parket mundet prapë të shfrytëzohet.

Kryetari – I ndërruar kuvendar po të premtoj para të gjithëve se unë nga sot nga mallrat dhe shërbimet do ti japë 5,000.00 € edhe pse ti the 2,500.00 € do të kushtoj, vetëm që ta sillni në gjendjen ashtu si ka qen ajo sallë. Dy ekipet e inxhinierëve dhe arkitektëve i kanë bërë llogaritë mirë dhe më kanë thanë që dëmi është 50,000.00 €, këtu nuk bëhet fjalë për prishje të një gypi por bëhet fjalë për prishjen e gjysmë parketit të sallës.

Avni Morina – Të nderuar do ju përgjigjem në pyetjet që i keni bërë, po ashtu do ju apeloja që mos ta prisni mbledhjen e kuvendit sepse muaji është i gjatë, ju lutem kurdo që keni nevojë për ndonjë pyetje jam i gatshëm që çdo ditë të ju përgjigjem në lidhje me arsimin. Znj. Mirjeta Krasniqi pyeti a ka ndonjë stimulim për nxënësit që kanë dalë të suksesshëm në gara, e nderuar ata nxënës që kanë fituar çmime në gara kanë mare mirënjoyje nga DKA-ja, kanë mare edhe libra shpërblime, kurse para nuk ju kemi dhënë, këto janë format e stimulimit që i kemi praktikuar vazhdëmisht. Sa i përket çështjes së projektit për eficiencës të energjisë, shkolla e Drenocit është e para, shkolla “Milaim Krasniqi” në Pastasel, shkolla “Rilindja” në Çifllak, dhe shkolla “Nisemi Elshani” në Nagavc, pra janë katër shkolla gjithsej nivel komune. Numri i madhe i mungesave është shqetësim për të gjithë, ne këtë gjendje e kemi gjatë, kjo që e shihni është gjendja e fundit e gjysmë vjetorit të parë dhe nuk janë marr

masa preventive, nëse do të ishin marr masa preventive në fillim nuk do ti ishte kjo gjendja kështu, kur kam ardhur unë në krye të DKA-së i kam obliguar dhe atëherë janë marr masa preventive. Po ashtu edhe unë mendoj që në kuadër të rekomandimeve ta bëjmë një plan për zbatimin e këtyre rekomandimeve, po ashtu të shndërrohen në rregullore të punës dhe mënyra e sjelljes sonë karshi arsimt vazhdimisht në mënyrë permanente të zbatohen këto rekomandime. Ne kemi kërkuar nga MASHT-i që të zgjerojmë stafin e DKA-së me pedagog dhe psikolog, shpresojmë se nga 1 shtatori ne të kemi një numër të psikologëve dhe pedagogëve në shkollat e komunës sonë. Po ashtu i kemi evidentuar nxënësit me nevoja të veçanta në secilën shkollë. listën e kam në zyre. Trekëndëshi shumë përmendur mësimdhënës, nxënës, prind, duhet që të zbatohet fillimi i zgjedhjeve nga DKA-ja në raporte me drejtore të shkollave dhe mësimdhënësit dhe pastaj të shkojmë me nxënës sepse nxënësit më së paku janë fajtor.

Kryesuesi – Ju faleminderit për debatin e zhvilluar rreth pikës së gjashtë, kalojmë në pikën e radhës:

7. Informatë rreth ecurisë së hartimit të PZHK-së.

Rumir Zhuniqi – Përshendetje për të gjithë të pranishmit, para jush do të paraqes ecurinë e hartimit të PZHK-së, komuna e Rahovecit ka filluar që të hartojet një plan të ri zhvillimor sepse plani i vjetër ose aktual që është në fuqi, është i mangët dhe nuk i plotëson të gjitha kushtet si një PZHK-ë. Vitin e kaluar me 31 mars 2017 kuvendi ka marr vendim për ta hartuar PZHK-në, ky dokument është dokument më i rëndësishëm i planifikimit të një komune, është plan multi sektorial, i cili planifikon që në një afat prej 8 viteve të gjitha aspektet e zhvillimit komunal. Ne si qeveri komunale i kemi zhvilluar të gjitha procedurat, që të hartojmë një plan zhvillimor, më përbajtjesor dhe më të qëndrueshëm si dhe më të zbatueshëm. Në bazë të planit që e ka miratuar kuvendi ne e kemi filluar edhe punën, ku jemi në fazën e parë të mbledhjes së të dhënavë, dhe e krijimit të profilit të komunës. Ne do të vazhdojmë sipas programit që ti hartojmë dhe që nga data 15 qershor do të vazhdojmë edhe me fazën e dytë që është përcaktimi i vizionit.

Rasim Fazliu – Është shumë mirë që kuvendi komunal e ke marr këtë propozim vendim për hartimin e PZHK-së, po ashtu edhe planin aktual ne e kemi bërë, por që nuk ka qen funksional, të ju them të drejtën jemi të zhgënji me këtë plan, prandaj tani ka lindë nevoja që të hartojet një plan i ri. Më vije shumë keq sepse goxha janë harxhuar mjete në atë kohë për këtë plan, ku edhe atëherë i kemi pasur disa debate goxha të nxehë rreth këtij plani, hartuesit të këtij plani i cili ka qen nga Prishtina i patëm thënë që ka bërë shumë kopë past dhe kjo nuk ka qen në rregull. Të gjitha këto jam duke ju thënë për një qëllim të mirë, është mirë që tani të mos përsëriten gabimet që i kemi bërë atëherë, por vërtet të bëhet një plan funksional zhvillimor për komunën tonë dhe shpresoj që nuk do të ketë më nevojë të ndryshohet, përmirësimet mundemi të bëjmë por jo të ndryshohet komplet.

Kryetari – PZHK-ja është për gjitha komunat e Republikës së Kosovës sepse ka ndryshuar ligji, po ashtu ka plane zhvillimore komunale të cilat janë mjaftë funksionale dhe nëpër komuna e tjera janë ende në fuqi, por ligji ka ndryshuar dhe fatkeqësisht apo fatbardhësisht komunat janë të detyruara që PZHK-në të bëjnë në përputhje me ligjin e ri. Disa pika të PZHK-së së vjetër janë zbatuar dhe kanë gjetur funksionalitet, ne besojmë se tani PZHK-ja e re është në nderin, detyrën dhe përgjegjësin tonë që vërtet, ashtu siç duhet edhe në përputhje me ligjin dhe në përputhje me interesat zhvillimore strategjike që i ka komuna. E tha drejtori që është hapi i parë është grumbullimi i të dhënavë, kurse faza e dytë do të ketë dëgjime publike dhe plotë procedura të tjera.

Fahrije Lushi Morina – Kryetari e dha shpjegimin e duhur edhe unë e kisha qëllimin që të insistoja tek kjo pjesa, meqë është një informatë që mungojnë shumë detaje dhe fakte rreth zhvillimit të këtij plani, mendoj që paraprakisht ne duhet që të kemi fakte ose detaje të cilat e përfaqësojnë më mirë dhe më në detaje PZHK-në.

Florije Boshnjaku – Falënderoj drejtorin dhe qeverinë komunale për këtë iniciativë, edhe ne si kuvend kemi dhënë një kontribut që me u miratu PZHK-ja, e di që ka punë dhe probleme sepse kemi punuar edhe më herët. Tani ka të bëjë me profilin e komunës, e ceku edhe kryetari se si është gjendja momentale e komunës dhe cili është vizioni për të ardhmen. Kam një propozim shpresoj se mundet që të kontribuojë në këtë çështje, është Strategjia e qeverisjes lokale e MAPL-së 2016-2026, është mirë që të mirën disa të dhëna këtu dhe të shihet sepse PZHK-ja duhet që të përputhet me strategjinë për qeverisje lokale i cili do të na kontribuojë neve si komunë dhe gjithë qytetarëve të Kosovës. Pajtohem me z. Risimin kur e tha se në PZHK-në e parë kemi pasur mangësi, por besoj se ajo ka qen një përvojë për ne, prandaj besoj se ky PZHK-ja e re do të jetë më adekuat dhe do të gjej zbatim.

Kryesuesi – Ju falënderoj për kontributin e dhënë për pikën e shtatë, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Stone Castle).

Kryetari – Të nderuar kuvendarë ju para vete e keni një material sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, po ashtu e keni edhe sipërfaqen dhe disa argumente, po ashtu edhe një propozim vendim për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për nevoja të një investimi i cili kap vlerën diku rreth 7 milion €. Po ashtu ka të bëjë me çështjen e integrimit dhe përfshirjes së qytetarëve në hapje të vendeve të reja të punës, këtu fjala është për një projekt, por ne si kuvend duhet që të kryejmë pjesën tonë të punës, kurse aspektet e tjera të cilat lidhen me pëlgjime ose përgjigje që duhet të merren nga institucionet e tjera të nivelit qendror do të mirën ata. Nëse do më pyeste mua dikush se ku janë synimet e realizimit të këtij projekti dhe çka përfiton komuna jonë nga realizimi i këtij projekti, do ju tha se ky projekt nuk i cenon vlerat e zonës në atë pjesë ku do të realizohet projekti, madje ja shtonë vlerat e zonës sepse është i një natyre që përputhet me specifikat e zonës, pastaj a jemi në të gatshëm me ja dhënë dritën e gjelbër një projekti të këtij lloji që ne synojmë ta quajmë agroturizëm, turizëm kulturor, forcim i ekonomisë vendore, hapja e vendeve të reja të punës etj. Besoj se edhe këto kushte ose kërkesa ky projekt i plotëson, pastaj nëse ne jemi përkrah nevojave të vazhdueshme që i bëjnë në përditshmëri për investimet e brendshme, investime të huaja, për investime strategjike dhe shumë të tjerë, besoj se edhe këtë kriter e plotëson realizimi i këtij projekti. Nëse në komunën tonë ndodhë një projekt rreth 7 milion € dhe pa asnjë obligim financiar nga Komuna e Rahovecit, por ka gatishmëri investitorit të investoj në këtë drejtim, besoj se nuk kam çka të shtoj më tepër, prandaj kërkoj nga ju që ta aproponi këtë propozim vendim.

Sali Sallteku – Pëershëndetje për të gjithë të pranishmit, e dëgjova me vëmendje kryetarin po ashtu edhe materialin e kemi lexuar, sa i përket interesit të komunës nuk do të flasë sepse nuk e di shumë se cili është interes, por lirishtë mundem të thëm se është një interes privat, por ajo që e di më së mirë është që ato prona kanë qenë të gjitha të qytetarëve të Komunës së Rahovecit, i ka marr një shtet që e dimë se si ka qen ai shtet ku i ka destinuar për interesat e veta. Po ashtu edhe kompania Stone Castle kur i ka marr këto parcela i ka marrë për të zhvilluar vreshtarin dhe bujqësinë, nëse këtë vreshtari që është traditë e kamotshme dëshirojnë komuna e Rahovecit ta kthejnë në hoteleri atëherë ajo është diçka tjetër. E di që edhe kryetari i partisë që i takojë unë ka qen një ditë në gur themelin, ka hengër ka pi aty dhe e di që në atë pjesë është duke u punuar dhe kjo që kerkohet nga ne është një formalitet prandaj unë personalisht nuk e përkrahi këtë propozim vendim, po ashtu kerkohet nga kuvendarët e tjerë që mos me e përkrah këtë propozim vendim sepse nuk është interes i qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe vetë Rahovecit si qytet me e humbë një pronë bujqësore e cila është me nam dhe me e kthye në turizëm hotelerie. Rahoveci është i ngulfatur besoni, kur kam qen drejtori i DKA-së kemi kërkuar që të ndërtojmë një shkollë nuk na ka lejuar pronë, mendoj se është ma shumë interes ndërtimi i një shkolle për fëmijë se sa ky hotel, me shumë mundime dhe bisedime na ka lejuar trafon që ta vendosim.

Kryetari – Me siguri komuna e Rahovecit dhe komunat e Kosovës kur ka ndodhur privatizimi qoftë me spinof special ndoshta kanë mundur me e dhënë një kontribut që me qen një privatizim pak më ndryshe e jo si ky që ka ndodhur. Ne tani jemi para një situate jo vetëm për pronat e Stone Castle, por edhe për shumë pronat e tjera, prandaj ne nuk duhet që këtu të flasim pa koncept sepse ne jemi para një fakti që dikush i ka privatizuar plotë prona që i ka në administrim plotë 99 vite kushdo qoftë ai, ne nuk jemi të vegjël dhe nuk është që nuk e njohim historinë si atë para lufte ashtu edhe atë pas lufte, privatizimi në disa komuna ka dështuar por komuna jonë ka pas sukses në privatizim dhe është storie e suksesit. Stone Castle e ka ruajtur veprimtarin, M- Sillosi pavarësisht ku jemi çka jemi është treguar që e ka ruajtur veprimtarin, pastaj Osa – Termosistemi e ka ruajtur veprimtarin, Bodrumi i Vjetër e ka ruajtur veprimtarin, Pista e cila merret me masa plastike e ka ruajtur veprimtarin, të gjitha këto vazhdojnë të janë ndërmarrje të suksesshme. Po ashtu ju siguroj unë se kush ka informata, z. Qeska ndoshta e dinë më mirë sepse ka punuar si avokat, privatizimi ndërmarrjes për të cilën sot jemi duke diskutuar në fillim e ka privatizuar dikush tjetër e pastaj janë bërë ato transaksionet që i dinë më së mirë ata se si i kanë bërë, por fakti që 55 hektar i ka mbjellë këtë vit në Polluzhë vreshta të rreja, 60 hektar i ka mbjellë vitin e kaluar, na del që është i interesuar që ta ruaj traditën vreshtarë të kësaj zone dhe natyrisht kjo traditë vreshtarë nuk mundet të jetë e kufizuar pa i pasur edhe disa komponentë shtesë. Vreshat janë vlerë kombëtare dhe vlerë e rajonit tonë me qendër Rahovecin, po ashtu edhe sektori i përpunimit të rrushit është një vlerë që shpesh herë konsiderohet edhe

si krenari e Kosovës dhe Agroturizmi është njëra nga komponentët që i lidhë këtë zinxhir. E thatë që është interes privat, po është e vërtet që është interes privat por nëse punohet me këtë logjik atëherë ne nuk mundemi me siguru që ndaj një situate të caktuar të përdorim një logjik të mohimit të fakteve, ndërsa ndaj një situate tjetër po ashtu ta përdorim një logjikë të favorizimit, në rastin konkret edhe njëherë projekt i është investim milionësh dhe kompania Stone Castle numëron diku rrëth 300 punëtorë, le të themi se 30 përqind i paska të Dukagjinit, edhe ne jemi Dukagjin, jemi Anadrini por jemi të këtij rajoni dhe pjesa tjetër janë punëtorë të Komunës tonë, ka plot teknologjë, teknik, ka plot punëtorë edhe nga Malësia e Vogël dhe plot nga vendbanimet tona, sigurisht që ne do të ishim të kënaqur po të kishte edhe dy herë më shumë punëtorë, edhe tri herë më shumë vreshta por unë nuk dua të diskutoj faktin se ka apo nuk ka interes privat, përfitimet e Komunës tonë janë që një projekt shumë milionësh që nuk i cenon vlerat e zonës sepse mos harroni se aty ka qenë tokë ndërtimore bile ka qenë pista e helikopterëve aty që ka mundësi edhe na kanë gjualjtur ndonjëherë gjatë luftës, po flasim përnjë tjetër zonë që nuk është ndërtimore por që ridestinimi i tokës mundëson që të shtohet edhe një dimension tjetër i zonës bujqësore që bujqësia nuk është vetëm me speca perime e pemë, bujqësia është edhe agro përpunim, bujqësia është edhe turizëm, kulturë, trashëgimi, monument, pra apeloj që në raste të tillë të jeni më të vëmendshëm dhe të keni kujdes në raste të tillë mos bëni paragjykime, në qoftë se dikush del një pronar i asaj toke që është pronar privat, kadastrën për çka e kemi? Gjykatën për çka e kemi? , e fiton të drejtën edhe jemi në rregull, deri më tanë nuk ka ndonjë situatë problematike me pronën dhe bashkëqytetarët tanë të cilët nuk kanë mundur të sigurojnë dokumente në kohën e privatizimit ose ndoshta nuk kanë argumente të mjaftueshme unë i ftoj të i sigurojnë tapitë edhe nuk ka askush që ja cenon të drejtën, por tash për tash ajo është pronë bujqësore dhe nga ne kërkohet që të jemi të vëmendshëm sepse ne kemi pasur ndërrim destinim të pronës, partitë politike në këtë Kuvend në legjislaturat e kaluara kanë aprovuar propozim vendime për ndërrim destinim të pronës, kështu që duhet të kemi vëmendje ndaj pronarëve që janë storie e suksesit, çka të bëjmë me ata që e kanë privatizuar dhe kanë dështuar, duhet të aprovojmë propozimin përi destinimin e tokës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, nuk përfundon puna këtu ka punë tjera edhe në qeveri, Ministrinë e Planifikimit, Ministrinë e Bujqësisë, mirëpo ne duhet të kemi vëmendje sepse kemi bërë ndërrim destinim të tokës në disa raste, e kemi rastin me bodrumin këtu Kosova Wine, raste tjera që unë i di edhe me emra e kemi ri destinu tokën për shkak se ka qenë një interes edhe ata kanë qenë privat.

Sali Salltekù - Nuk ishte puna sa njerëz janë punësuar qëllimi ishte tek veprimtaria e një kompanie, veprimtaria e kësaj kompanie që 99 vite është bujqësore dhe këtë e flas me kompetencë, Kryetari po thotë se duhet me pas koncept, koncept nuk mbajte as ti aty, unë po të them që e kam lexuar këtë disa herë edhe me koncept shumë të mirë po ta them, d.m.th qëllimi që e the vetë edhe ti është që ti ruhet veprimtaria një kompanie, nuk thashë as që ja kemi pa sherrin, M-Sillosi, Osa Termosistem, Stone Castle veç të mirat që ju kemi parë, por le ta ruan atë veprimtari që e ka mos ta ndërron destinacionin këtu ishte qëllimi i kësaj.

Kryetari- Edhe njëherë e thashë më herët me ri destinim të tokës nuk i ndërrohet karakteri, nuk i ndërrohet synimi për shkak se një qendër rezidenciale, kreative është komponent që e forcon ato që po thua ti Sali , nuk del jashtë sferës së bujqësisë, thashë prona është në kuadër të Stone Castle që 99 vite, pra është pronë e vetja a kanë bërë mirë ose jo kur është privatizuar ajo punë ka përfunduar.

Qazim Qeska - Unë kërkesën e palës Stone Castle me pronar Rrustem Geci e kam lexuar dhe është shumë e justifikueshme, me vëmendje e kam dëgjuar edhe arsyetimin e Kryetarit, mirëpo me të vërtetë kam vërejtje në përbajtjen procedurale të projekt vendimit vërejtjet apo të meta të cilat mund të kenë reperkusione që në fazën e nesërme për drejtorinë e urbanizmit, nesër pala kérkon ti lëshohet leja , a mund të lëshohet leje ndërtimi në bazë të këtij vendimi, ne nuk jemi kundër fare dhe arsyeshmërinë ekonomike por do të doja që drejtori i DPZHR-së ose zyra ligjore të jep disa arsyetime të cilat kundërshtojnë njëra tjetrën një paragraf me paragrafin tjetër, përndryshe destinime ka pasur edhe në të kaluarën, të tashmen dhe do të ketë edhe në të ardhmen, nuk ka asgjë të keqe këtu arsyetimin ekonomik, arsyeshmërinë e dha Kryetari nuk ka diskutim mirëpo zoti Kryetar ju morët përgjegjësinë ta arsyetonit në aspektin profesional, unë mendoj në qoftë se ky vendim kalon në këtë formë e që nuk dyshoj atëherë do të ketë reperkusione me pasoja për palën edhe për neve atëherë ju lutem unë mundem me dhënë kontributin tim, paraprakisht drejtori e dha arsyetimin lidhur me ecurinë e Planit zhvillimor të Komunës së

Rahovecit, forma si parashihet këtu nuk e di kush e ka përpiluar do të jetë pjesë e kësaj e kësaj nuk i përkon Qeverisë Komunale, ne jemi institucion ligjor, Kryetari është organ ekzekutiv që nesër do ta ekzekutojë këtë vendim, këtë drejtë do të kërkoja prej zyrës ligjore një arsyeshmëri lidhur me paragrafin e secilit nen të këtij projekt vendimi.

Isak Hoti- Siç edhe e dini në PZHK pjesa në Bërrnjakë nuk është e përfshirë hiç, përderisa nuk është e përfshirë ligji na thotë se ne kemi të drejtë të nxjerrim një vendim dhe ta bëjmë pjesë të PZHK-së atë pjesë, nuk flitet përmijëra hektarë flitet përmijëra 97 ari pronë, neni 44.1 thotë deri në nxjerrjen e PZHK-së toka bujqësore për qëllime jo bujqësore mund të bëhet vetëm me vendimin e KK, në këtë rast KK nxjerr një vendim nuk jemi organi i fundit që e mbyllim këtë punë, ky vendim shkon në ministrinë e planifikimit hapësinor dhe nga ty niset në MPZHR, ku një komision që është i formuar prej tri ministritë të përbashkëta del në terren dhe verifikon gjendjen faktike, mirëpo kjo procedurë fillon prej kuvendorit vendimi nuk bien në kundërshtim me ligjin është absolutisht në përputhje përmijëra shkak se jo fastësish e kemi përmendur që kjo bëhet pjesë e PZHK-së, një gjë ju garantoj që është në mos përputhje me ligjin Ministria e Planifikimit Hapësinor do të na kthejë dhe këtë e marr barrë unë, te çështja e lejes ndërtimore ne e kemi cekur te pika 5 është a dhe b sipas udhëzimit administrativ ku ai duhet të bëjë pagesën para se të marrë lejen ndërtimore, nëse nuk gaboj përmijëra 1m² udhëzimi administrativ e përcaktion 1€, edhe konform kësaj mirët leja përmijëra ndërtim, plus një muaj do të jetë pjesa e mekëtës përmijëra ankesa, nëse dikush ka, plus tokat përreth tij janë në pronësi të tij kështu që ne sa i përket ligjit jemi në përputhshmëri.

Qazim Qeska- E thashë që ka të meta shumë edhe pse ato procedurale dhe gjuhësore po i tejkaloj mirëpo unë e thashë dhe ju e dini mirë që toka e klasit të parë vetëm në raste të jashtëzakonshme mund të ridestinohet që e dha një arsyetim ekonomik, plotësisht pajtohem me Kryetarin mirëpo ju keni mundur edhe mundeni pse nuk e plotësoni PZHK aktual i cili është ende në fuqi që e keni procedurë ju është diçka tjetër ne mundemi me inkorporu mirëpo deri në inkorporim të kësaj parcele, unë nuk jam kundër me inkorporu, nesër del edhe dikush tjetër të na kërkoj besoj e zgjerojmë atë zonën mirëpo a është e udhës ka juristë këtu plotësim ndryshimi me një vendim aneks shumë të vogël i planit aktual zhvillimor edhe mos të ketë pasoja, ky është qëndrimi im në të kundërtën nesër ky vendim do të jetë në kundërshtim me PZHK-në, si do ta inkorporoni ju këtë parcelë në PZHK me cilën procedurë zotëri shef i zyrës ligjore, unë dua të jap kontributin tim që nesër mos të ketë pasoja përndryshe kushdo qysh do le të flet është një arsyeshmëri ekonomike, unë e thashë kërkesa i plotëson të gjitha konditat e saja, çka do të bëhet në të ardhmen është çështja e tij sidoqoftë ky është mendimi dhe propozimi im, me këtu edhe po e përfundoj.

Isak Hoti- Neni 10 i ligjit përmijëra bujqësore i specifikon qartë cila tokë në cilën kategori është, ku ka mundësi të bëhet ndërrim destinimi, pastaj është edhe udhëzimi administrativ i cili edhe ai i specifikon shumë qartë, po them që nuk jemi të vetmit që e kemi bërë këtë por e kemi edhe plot komuna tjera, neni 8 thotë vendimi përmijëra ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i ka 8.9 paragrafe ku përmes tjerash thotë tek 8.4 organi përkatës i komunës do ta përgatisë udhëzimin e vendimit të cilin do të merr Kuvendi Komunal, projekt propozimi do të përbëjë dokumentacionin të parashtruar dhe informatat vijuese: arsyeshmëria siç u tha, vendimi, propozimi me arsyetim, shuma kompensuese të cilat duhet ti paguajë parashtruesi i kërkuesës, nëse Kuvendi Komunal miraton kërkuesën përmijëra ndërrim destinim brenda 5 ditëve të punës së marjes së vendimit Komuna do të kërkojë pëlqim nga Ministria, duke parashtruar projekt propozim vendimin përfundimtar, përmijëra që është në përputhje me ligjin është, ne kemi shkuar në përputhje me ligjin z. Qeska.

Qazim Qeska – Nuk e di pse e gjithë kjo retorik përmijëra neni 3, kuvendi është organi më lartë, pse nuk thuhet në neni 3, është pjesë e PZHK-së.

Isak Hoti - Si të shkruajmë diçka kur nuk është , z. Qeska lexoi nenet i ke para vete. Neni 44.1 thotë decidivisht: Deri në nxjerrjen e PZHK-së toka bujqësore përmijëra qëllime jo bujqësore mund të bëhet vetëm me vendimin e KK, ne e kemi këtë të drejtë sepse ligji e thotë e jo unë. Mundem me e cekë që është pjesë e PZHK-së, por nuk dua pasi nuk është dhe e di se çka thua ti pastaj. Krejt që dua të them është se kjo është një çështje e kuvendorit dhe ju jeni ata që vendosni, ose e votoni sot ose jo, është punë e juaja, por debatin mes juristëve nuk jam duke e parë që je duke e bërë bash korrekt.

Dervish Çadraku – Fillimisht e kam një vërejtje të vogël edhe për kryetarin edhe për përfaqësuesin ligjor, pyetjet dhe përgjigjet bëhen në fund mendoj sepse tani jeni duke na humbur kohë sepse ne duhet që të debatojmë. Në KPF kam abstenuar për këtë pikë për arsyen se materiali ka ardhur në ditën e mbledhjes dhe kjo praktik duhet që të eliminohet një herë e përgjithmonë. Kurse tani janë duke na dalë dy dobësi, e parë që materiali ka ardhur në ditën e mbledhjes që kjo tani është tejkaluar, por dobësia e dytë është se unë e kam parë në televizion se gur themeli është nisur dhe është duke u punuar, çka do të ndodhë nëse ne nuk e kalojmë këtë propozim, çka do të bëjë ai me ato punime. Komuna është kompetente vetëm për bizneset e vogla dhe të mesme sepse për këto të mëdha nuk na vetë askush siç duket, shumë persona kanë thënë që ligjet në Kosovë janë shumë të mira, ndoshta më të mira në Evropë por implementimi është shumë problem. Është dashur për shkaqe korrektësie ky debat të zhvillohet para se të ja fillojnë punimet atje e jo tani. I nderuar kryetar sa i përket privatizimit në Kosovë është bërë në mënyrë stihike mos të them në mënyrë të egër, plotë kompani të mëdha që janë privatizuar janë pasuruar të pasurit, kurse të varfëritë kanë ra edhe më poshtë, e përmende M –Sillasin i cili i ka pasur 430 punëtor, kurse sot i ka 30-40 punëtor, Stone Castle i ka pasur 1000 punëtor sot i ka 300, por edhe kaq nuk e besoj se i ka. Është profitabile kjo që po propozoni sepse njerëzit do të na dalin jashtë krejt edhe pse kjo nuk është prodhimtari, por në fund të fundit është një biznes që i punëson diku 50-60 persona. Është mirë që të përcillen procedurat dhe të shkojmë si një shtet ligjor i cili shkon në bazë të rregullave që i ka përcaktuar vetë.

Mirjeta Kransiqi – **Nuk jam juriste por ajo që mundem të kuptoj është se ne kërkesën e kemi para vete për ndërrim destinim, çka do të bëhet nëse ne sot nuk e aprovojmë këtë propozim vendim, sepse siç e thanë kolegët ndërtimi veç ka filluar, pastaj çka nëse ne e aprovojmë por e kthen si të paligjshëm ministria përkatëse. A do të kishte mundur ai të tërhiqet nga ndërtimi i këtij hoteli, pastaj ju e thatë që ende nuk ka marrë as leje, është interesante se si ka filluar të ndërtoj kur ende nuk është pajisur me leje ndërtimi. Ne e përkrahim këtë propozim sepse është milionësh, prandaj mendoj se kishte me qen më mirë nëse do të kishte gjetur një vend më adekuat për ndërtimin e këtij hoteli. Kjo tokë është privatizuar për 99 vite, mendoj se hoteli do të qëndroj më shumë se 99 vite dhe çka do të bëhet pastaj, a do të merr ai përsëri këtë tokë në privatizim.**

Rasim Fazliu – Të ju them të drejtën shumë gjëra që desha të i them vetëm se u thanë nga kolegët parafolës, pajtohem edhe me kërkesën e Stone Castle, po ashtu pajtohem edhe arsyeshmërin që e tha kryetari, mendoj se është investim me vend sepse ne duhet që ti joshim turistët e huaj dhe të vendit me këso lloje objektesh dhe në këtë mënyrë ja risim performancën komunës sonë. Por ajo që më pengon mua të ju them të drejtën është se: Para se të gjuaj një lopatë dhe ose çka do qoftë që ka hedhur është dashur së pari të vije në kuvend dhe jo tani të na pyes formalisht neve, besoj se ne sigurisht se do të ishim pro kësaj. Mua nuk më pengon që do të shndërrohet nga toka bujqësore në tokë ndërtimore sepse ajo vetëm që figuron si tokë bujqësore sepse aty është e gjithë pjesa me beton, ne nuk jemi duke prishur kurrrafë gjeografie aty. Por e vetmja gjë që më shtynë ndoshta që të votojë edhe kundra është, pse janë duke na pyetur vetëm formalisht, kush jam unë atëherë, çfarë roli kam dhe nuk është fare mirë që të na qesin neve par një akti të kryer, po ju them sinqerisht jo vetëm për këtë projekt por edhe për të tjerë, duhet që të marrin vesh se nuk mundem me lozë me ne. Pastaj shtrohet e njëjta pyetje si e kolegëve nëse ky kuvend nuk e voton, a thua do të ndërtohet ky kompleks turistik.

Flrije Boshnjaku – Mendoj se secili nga ne kemi të drejtë me i shpreh mendimet tona dhe të shprehemi lirshëm për atë që jemi duke menduar të bëjmë. Desha të ndërlidhem me kolegun z. Qazim Qeska kur e tha se duhet që të plotësohet ky vendim, nëse duhet që të plotësohet ky vendim kishte me qen mirë që të na ndihmoni sepse besoj s'ene për këtë jemi këtu. Sa i përket çështjes së privatizimit ne e dimë se si ka shkuar por askush nuk na ka pyetur neve, teni këtu bëhet fjalë për një biznes, ne këtu konkretisht e kemi rastin dhe nëse ne mundemi që të kontribuojmë në mënyrë pozitive që ky vendim nesër të gjejë zbatim, atëherë ne secili duhet që të japid kontributin tonë, të i përmirësojmë gabimet dhe ta qesim në votim në mënyrë që ky propozim të kalojë.

Fehmi Cena – E kam lexuar me kujdes edhe kërkesën por edhe propozim vendimin, e kam mendimin time sigurisht dhe paraprakisht, besoj se shumica e kanë qëndrimin e vetë për këtë çështje. Mirë është që është duke u debatuar në mënyrë që secili të jepe mendimin e vetë, kështu që do të dalin edhe anët pozitive edhe anët negative dhe në fund është mirë që të marrim një qëndrim sa më pozitiv. Do i përmendi disa gjëra që nuk u përmendën nga kolegët, në vendin ku do të ndërtohet ky objekt sa e di ka ekzistuar një objekt më parë, më duket ka qen po ashtu

hotel, pastaj aty ka qen heliodromi, pjesë e cila nuk ka vreshta dhe nuk ka të mbjella bujqësore. Këtu bëhet fjalë për një kompani e cila i ka në posedim diku rrëth 600 hektar dhe është duke kërkuar nga ne ndërrim destinimin të tokës rrëth 1 hektar, prapë veprimitaria e tyre qëndron, prandaj për mendimin tim arsyeshmëria qëndron, Rahoveci qoftë si qytet, qoftes i komunë asgjë të keqe nuk do të ketë nga ky projekt, por besoj se do të ketë vetëm anë pozitive.

Kryetari – Këtu po dele sikurse ne jemi par një akti të kryer, kjo nuk është e vërtet, po i përgjigjë z. Rasim, z. Dervish dhe kushdo që me të drejtë e ka ngritur këtë shqetësim. Ka ma shumë se një vit e gjysmë që diskutohet ky projekt, por është fati i mirë që pas një diskutimi të gjerë kemi mbërritur me e gjete një modalitet ose rrugën më të quartë më të drejtë dhe më të saktë, e ky është modaliteti ligjor. Komuna jonë për herë të parë ballafaqohet me atë që e tha z. Qeska, kategoria e klasit të parë tokë bujqësore, faji nuk është as tek kompania dhe as tek komuna pse ka ardhur materiali me vonesë në KPF/Z. Rustem Gecaj është njeriu i cili rinë në Amerikë dhe në Kosovë, ai ka vendosur në rastin konkret me i investuar duku rrëth 7 milion, ai nuk e ka pasur të quartë, po ashtu edhe sot nuk e ka të quartë pse aq shumë vonesa janë duke u bërë kur dikush dëshiron të investoj diçka në tokën e vetë. Prandaj vonesat kanë ardhur si rezultat i mungesës së fakteve të mjaftueshme ligjore dhe dilemat që nuk është në plan zhvillimor komunal, ndërkohë ne jemi duke e bërë PZHK-në e re, po ashtu kanë filluar procedurat edhe për hartat zonale dhe sigurisht që ne kemi me pas raste të tillë edhe në situatat e objekteve afarishte të cilat janë shumë të rëndësishme për ekonomin e Rahovecit. Tendenca jonë është që të hymë drejtë legalizimit të objekteve edhe pse nuk është në planin zhvillimor, por do të jetë në planin zhvillimor, nuk ka leje tanë sepse nuk është në planin zhvillimor, por do të merr leje në të ardhmen, do të ketë një pagesë fillestare ku pastaj do ti kalojë të gjitha këto procedurat ligjore. Për koincidence unë nuk kam qenë kur i kanë hedhur ato dy – tre lopata beton sepse kam qen Jashtë shtetit, ajo është simbolikë asgjë më tepër, punimet nuk kanë filluar, ata janë vetëm duke e rrafshuar terrenin, po ashtu ata besojnë se shteti i Kosovës ka gatishmëri të plotë që investime e tillë të i absorbojë duke qenë dakord plotësisht me ligjin. Prandaj po ju them se nuk jemi para akitit të kryer, kjo ka qen për simbolikë, kam qenë prezent në Stone Castle kur kanë ardhur 120 persona nga shteti Ajova i Amerikës, ku komuna jonë ka bërë kërkesë në kohën e z. Vehapi që të binjakëzohet me një komunë të shtetit të Ajovas, jemi në pritje të një përgjigje pozitive. Realisht më duket që ne jemi vonuar si kuvend ndërkohë që aty më duket sikurse është duke u punuar, por aty nuk është duke u punuar por vetëm është rrafshuar dhe është hedhur vetëm një gur themel ku ka marrë pjesë Kryetari i parlamentit të shtetit të Kosovës, të i lëmë partitë politike anësh. Realisht jam duke besuar se Rahoveci është duke u kthyer në një zonë të interesit strategjik për zhvillimin ekonomik, dhe besoj se është mirë që e kemi ne si komunë një Rustem Gecaj ose një Rasim Fazli etj. Kushdo qoftë që është i interesuar që të investoj në komunën tonë është i mirëseardhur. Prandaj ne duhet që të ja japid drithën e gjelbër, natyrisht në pajtim të plotë me procedurat siç i tha edhe z. Qeska dhe shefi i zyrës ligjore, po ashtu nëse gabon ky kuvend ministritë e linjës do na kthejnë për rishqyrtim me vërejtjet e dhëna nga ta, ku pastaj do e përmirësojmë dhe do e qesim prapë në kuvend, asgjë të keqe nuk ka këtu. Është mirë që mos të i lëmë ata më të mëdhenj që ti thërrasin shefat e grupeve të partive politike që janë në kuvendin e komunës dhe na bëjnë urime së bashku me ambasadorin e SHBA-së, ne nuk duhet që të lejojmë që të vijmë në këtë pozitë.

Qazim Qeska – E thash të nderuar se e dëgjova arsyetimin për këtë pikë dhe për gjithçka pajtohem, por në aspektin profesional më pengjnë disa gjëra që janë të përfshirë në këtë propozim vendim. E dinë kolegët që janë juristë se vendimet juridike prodhojnë efekt, prandaj nuk duhet që në vendim të ceket do të jetë, nëse e themi do të jetë atëherë kjo nuk prodhon efekte juridik. Të nderuar pse e keni cekë si Vendim paraprak për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore, ne jemi duke ja ndërruar destinimin dhe kush po na ndalon që të cekim se nuk është pjesë e planit dhe do të jetë pjesë e planit. Nëse e bëjmë kështu si ethëm unë dhe na e kthen ministria, jam i gatshëm që të përballem me secilin për ta mbrojtur këtë që jam duke thënë.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin Vendimin për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Stone Castle), me vërejtjen nga z. Qazim Qeska që të përmirësoset vendimi: Konstatoj se me 5 abstenime dhe 19 vota pro është aprovuar pika e tetë (8) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Rahovec, parcelat 03709-0, 03710-0.

Afrim Orupi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në adrës të zyrës së kryetarit dhe drejtorisë për bujqësi dhe drejtoreve tjera përkatëse kanë ardhur shumë kërkesa në lidhje me pronat komunale, të cilat kërkojnë nga ne që ti jepim në shfrytëzim me periudhë kohore afatshkurtër 1-15 vite. Ne si drejtori për gjeodezi kadastër dhe pronë i kemi përgatitur propozim vendimet, ku i kemi evidentuar të gjitha këto kërkesa, pastaj i kemi evidentuar pronat përkatësisht ka janë të orientuara palët, fillimisht destinimi i tyre ka qen për veprimitari bujqësore. Zona kadastrale është në Rahovec, zona kadastrale në pikën nëntë ka të bëjë me dy parcele, dy parcella kanë shkuar me të njëtin vendim për arsy se kufizohen njëra me tjetrën, njëra parcella ka sipërfaqe prej 12 ari e 25 m², kurse parcella tjetër ka sipërfaqe prej 6 ari e 16 m². Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është që këto parcella të përpunojnë, pastaj këto parcella të prodhojnë vende punë, të rrashohen dhe në fund të ruhen. Ne kemi trashëgpar një raport me mbi 230 prona komunale të cilat janë të uzurpuara, nëse këto kërkesa për shfrytëzim të pronave pas shqyrtimit nga ana e juaj aprovohet dhe ju jepet në shfrytëzim, atëherë komuna e Rahovecit dhe zyra e kryetarit kujdeset që me përfituesin të kalojë në komision për dhënин në shfrytëzim të pronës në afatshkurtër, ku do të vendosen kritere nga ky komision, pastaj del në ankand publik. Po ashtu me këtë do të ritën të hyrat e komunës sonë, por e mirë e krejt kësaj është që do ta dimë se kush i shfrytëzon këto parcella. Pronarët të cilët i fitojnë këto prona nuk kanë me pas të drejtë me i dhënë dikujt tjetër me qira, pastaj nuk do të kenë të drejtë me e ridestinu qëllimin e kërkesës. Propozimi i kryetarit për këto parcellë është me afat kohorë prej 15 viteve, ju ftoj që pas shqyrtimit të këtij propozim vendimi ta votoni të njëtin.

Masar Popaj – Në këtë propozim vendim në pikën 3 nuk janë dhënë sqarimet e duhura, në këtë pikë shkruan: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale si dhe krijimi i kushteve të volitshme për zhvillimin e aktivitetit të blegtorisë dhe dhënien e mundësisë qytetarëve për vetëpunësim. Por në bazë të certifikatave të pronës shihet se kemi të bëjmë me sipërfaqe të vogla të pronës, kërkoj që të jepen sqarime për shfrytëzuesit, a do të ju lejohet ngritja e objekteve apo do të ju jepen në shfrytëzim vetëm për kullosë.

Ali Morina – Pasi që drejtori e arsyetoj propozim vendimin dhe vërtet qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është ruajtja dhe rritja e vlerës së tyre, por edhe një mundësi e vetë punësimit të përfituesve të kësaj parcele, prandaj ne grupi i AAK-së i jepim mbështetje të plotë këtij vendimi.

Rasim Fazliu – Mendojmë që arsyeshmëria është dhënë këtu që të ruhen pronat tona komunale, po ashtu këtyre pronave do i ritet vlera, mendoj se kjo është shumë në rregull, por ndoshta do të ishte mirë që për gjitha vendimet edhe ato që vinë pas këtij vendimi sot, të ceket destinimi sepse përfituesi mundet pastaj të ketë të drejtë të shfrytëzoj diçka që nuk na konvenon ne. Do të dalë me një propozim konkret në emër të grupit: Ne si grup i PDK-së propozojmë që afati kohore për shfrytëzim të këtyre parcellave të jetë 10 vite.

Dervish Çadraku – Ne i kemi disa vendime këtu që janë përafersisht të ngjashme, është shumë mirë që janë duke u dhënë në shfrytëzim këto parcella qytetarëve sepse ndoshta e risin kualitetin e punës dhe vetëpunësoken, pra ka shumë të mira nga kjo punë. Por kisha menduar që kishte me qenë mirë që ne të i kemi pronarët sepse gjithmonë ekziston rreziku që të ndryshohen destinacionet, dhe destinacioni më i keq kishte me qenë nëse bëhet ndërtim në këto parcella. Nëse dikush del dhe na siguron se nuk do të ndryshohet destinacioni dhe njerëzit të cilët do të marrin do të janë të arsyeshëm, normal që do të jemi dakord sepse një kategori e njerëzve mundet të punësohet aty.

Kryesuesi – E kishim një propozim nga shefi i grupit të PDK-së z. Rasim Fazliu që afati kohorë të jetë për 10 vite. E qes në votim propozimin e z. Rasim Fazliu: Konstatoj se me shumicë të votave është aprovuar propozimi i z. Rasim Fazliu. E qes tanë në aprovim propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Rahovec, parcelat 03709-0, 03710-0: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e nëntë (9) e rednit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fshatin Çifllak, parcela 00217-1.

Afrim Oruçi – Ky propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër ka të bëjë me zonën kadastrale Çifllak me Nr. 00217-1, në vendin e quajtur shtupika kullosë e klasit të katërt. Qëllimi është i njëjtë sikurse i propozim vendimit të parë. Ftojë kuvendarët që pas shqyrtimit ta mbështesin propozim vendimin e kryetarit të komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 15 vite.

Kryesuesi – Të nderuar afati kohorë i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër jemi dakorduar që të jetë për të gjitha propozimet që do ti kemi sot për 10 vite. E qes në votim propozimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fshatin Çifllak, parcela 00217-1: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dhjetë(10) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fshatin Çifllak, parcela 00217-2.

Afrim Oruçi - Ky propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër ka të bëjë me zonën kadastrale Çifllak me Nr. 00217-2, në vendin e quajtur shtupika kullosë e klasit të katërt. Qëllimi është i njëjtë sikurse i propozim vendimit të parë. Ftojë kuvendarët që pas shqyrtimit ta mbështesin propozim vendimin e kryetarit të komunës për dhënien në shfrytëzim.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fshatin Çifllak, parcela 00217-2: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e njëmbëdhjetë (11) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Rahovec - Rimnik, parcelat 03818-0, 03870-0, 03871-0, 03819-0.

Afrim Oruçi - Ky propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër ka të bëjë me zonën kadastrale në Rahovec në vendin e quajtur Rimnik e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec, me numër të Certifikatës së pronësisë, këtu kimei të bëjmë me katër parcela: Qëllimi është i njëjtë sikurse i propozim vendimit të parë. Ftojë kuvendarët që pas shqyrtimit ta mbështesin propozim vendimin e kryetarit të komunës për dhënien në shfrytëzim.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Rahovec - Rimnik, parcelat 03818-0, 03870-0, 03871-0, 03819-0: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytëdhjetë (12) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Caktimin e Lokacionit për Vendosjen e Trafostacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale.

Përparim Krasniqi - Këtu kemi të bëjmë me një trafo e cila është e vendosur para dyerive të një banori nga Krusha e Madhe, nga ne kërkohet që kjo trafo të zhvendoset në një pronë tjetër, ne e kemi caktuar zonën se ku do të a vendosim këtë trafo dhe nuk do të ketë kurrfarë pengesa. Kërkoj nga ju që ta mbështesni këtë propozim vendim.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin për Caktimin e Lokacionit për Vendosjen e Trafostacionit dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e trembëdhjetë (13) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

14. Marrja e Vendimit për formimin e Komisionit ad - hoc për zgjedhjen e Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi – Për të na sqaruar fjalën rreth kësaj e ftoj shefin e zyrës ligjore z. Isak Hoti.

Isak Hoti – Të nderuar nga ne sot këtu kërkohet që të i propozojmë 2 emra të cilët do të janë pjesë e komisionit për zgjedhjen anëtarëve për këshillin e fshatit të Hoçës së Madhe, gjithsej duhet që të janë 5 anëtar të komisionit, 2 i zgjedhë kuvendi 1 vjen nga kisha ortodokse serbe dhe 2 na vijnë nga fshati Hoçë e Madhe. Kryetari i fshatit Hoçë e madhe na ka sjellë dy emra të banorëve të fshatit Hoçë e Madhe, tanë na mbetet vetëm ne që ti propozojmë dhe në fund të hedhet në votim komplet komisioni ad hoc.

Rasim Fazliu – Ne grupi i PDK-së propozojmë për anëtar të komisionit ad hoc z. Sali Sallteku.

Ali Morina - Ne grupi i AAK-së propozojmë për anëtar të komisionit ad hoc z. Bajram Morinën.

Fehmi Cena - Ne grupi parlamentar i LDK-së kandidat për komisionin Ad Hoc propozojmë delegatin z. Masar Popaj.

Kryesuesi- Meqë kemi më tepër se dy propozime obligohemi që të shkojmë në votim të fshehtë sepse na duhen vetëm dy kandidatë.

Sali Sallteku- Faleminderit për propozimin unë në vend timin propozoj z. Astrit Thaqi, sepse nuk kam mundësi të jem pjesë e këtij komisioni për shkak se jam i zënë, ju lutem të keni mirëkuptim.

Rasim Fazliu- Ne e propozuam z. Sali Salltekun, por ai po tërhiqet dhe arsyet i dha pse dhe ne e mbështesim kërkesën e tij, atëherë ne propozojmë për komisionin Ad Hoc z. Astrit Thaqi, faleminderit.

Kryesuesi- Shkojmë në një pauzë prej dhjetë minutash deri sa Administrata e kuvendit të i përgatisë fletëvotimet. Z. Rasim Fazliu kërkon fjalën që të na jepe një sqarim të vogël.

Rasim Fazliu- Ne pasi ja kemi nisë me i ndëru kandidatët, tani jemi në vazhdimësi të ndërrimit, për herë të fundit tani jemi duke e propozuar për anëtar të komisionit z. Munib Durguti.

Kryesuesi – Tani duhet së pari të formohet një komision verifikues për mbarëvajtjen e procedurave të votimi, anëtarët e këtij komisioni duhet që propozoni ju.

Rasim Fazliu – Ne grupi i PDK-së e propozojmë znj. Besmire Bytyqi, ju faleminderit.

Ali Morina – Ne grupi i AAK-së e propozojmë znj. Fjolla Duraku.

Fehmi Cena – Ne grupi i LDK-së propozojmë z. Faton Ramadani.

Kryesuesi – I qes në votim anëtarët e Komisionin për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së procedurës së votimit: Konstatoj se në mënyrë unanim janë aprovuar emrat e anëtarëve të komisionit. Fjalën e ka z. Isak Hoti shef i zyrës ligjore, që të na bëjë një sqarim rrith procedurës së votimit.

Isak Hoti – I kemi tre propozime, votimi shkon njëjtë sikurse në zgjedhjet lokale, i kemi pasur 34 delegat në listë por është votuar një kandidat, edhe në këtë rast duhet që votë një ta rrumbullakosni, pra një votë një kandidat. Dhe dy të parë që marrin ma shumë vota, do të janë anëtar të komisionit.

Rasim Fazliu – Ne duhet që ti zgjedhim dy kandidat për anëtar të komisionit ad hoc, tani i kemi tre kandidat të propozuar dhe për këtë ne duhet që të shkojmë në votim të fshehtë, mendoj se është ligjore që nga tre kandidat dy të rrumbullakohen e jo një siç e tha z. Isak Hoti. P. Sh për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës kemi pasur 30-40 në listë por unë kam pasur të drejtë pesë të i rrumbullakos.

Faton Ramadani – Të nderuar është gabim ajo që ju jeni duke thënë, sepse ky votim nuk ka fare lidhje me votimet që janë duke u organizuar nga KQZ-ja, aty votohet vetëm një subjekt politik, kurse këtu kemi dy e më tepër. Këtu mundemi të kemi 5 deri në 15 kandidat por janë duke u kërkuar 2, prandaj mendoj se një kandidat duhet që ti votoj një ose dy por jo më shumë, nuk e di ku është duke u bazuar zyrtari ligjor që e tha atë.

Dervish Çadraku – Edhe unë jam i pajtimit që duhet të votohen dy kandidat, jam duke folur nga përvoja.

Munib Durguti – Është shumë e logjikshme ne kemi me i zgjedhë dy kandidat dhe nuk ka asnjë logjikë që ne të i kufizojmë anëtarët e kuvendit që të votojnë vetëm një kandidat, ne si kuvend duhet që të zgjedhim dy kandidat që do të janë anëtar të komisionit ad hoc. Nëse sipas shefit të zyrës ligjore është ajo që ai është duke e thënë, le të na sjellë argument se ku është duke u bazuar, cilat dispozita ligjore e thonë këtë që ne obligohemi që të votojmë vetëm një kandidat dhe ne do të pajtohemi.

Ali Morina – Konsideroj që në këtë rast duhet që të merret për bazë ligji për zgjedhjet lokale për kuvendin komunal, ku e potencon se duhet të votohet vetëm një kandidat.

Astrit Thaqi – Përshëndetje për të gjithë, i nderuar z. Ali Morina, zgjedhjet lokale dhe qendrore i organizon KQZ-ja, këtu KQZ nuk ka ne jemi kuvend, i kemi tre kandidat, dy duhet që të zgjidhen prandaj dhe dy duhet që të votohen, nuk është hera e parë që kemi këso raste.

Fehmi Cena – Juristë nuk jam por mendoj se më e logjikshme është që të votohet për dy kandidat sepse dy kandidat duhet të zgjidhen, çka ndodhë nëse të gjithë ne votojmë vetëm për një kandidat, atëherë nuk do kryhet puna. Vet logjika e thotë se duhet të votohen 2 kandidat e jo më shumë se dy në këtë rast.

Qazim Qeska – Z. Kryesues është shumë e logjikshme, ne i kemi 3 kandidat, këtu është në pyetje e drejta dhe neve po na imponohet obligimi, nuk mundet askush të na kufizojë që të votojmë vetëm një kandidat pasi do të

zgjidhen dy kandidat nga tre anëtar. Pra të drejtë kemi me votu dy kandidat, të obliguar nuk jemi por të drejtë kemi një ose dy në këtë rast e jo më shumë.

Fatmir Iska – Të nderuar ju mundeni të hidhni në votim që të votoni dy ose një kandidat, pasi jeni duke ngulur këmbë, ne i kuqojmë edhe këto marrëveshje politike pozitë opozitë janë të kuptueshme. Nëse lidhem me parafolësin atëherë në listën zgjedhore qoftë lokale qoftë edhe qendrore atëherë ne kemi të drejtë të i zgjedhim nga 31 kandidat, por nuk është ashtu sepse në lokale kemi të drejtë vetëm një kandidat kurse në qendër kemi të drejtë pesë, pra të kufizohet e drejta.

Rasim Fazliu – I nderuari kryesues propozoj që propozimin që të votohen dy kandidat nga 3 sa janë të propozuar ta hidhni në votim dhe le të vendos kuvendi.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e z. Rasim Fazliu që të votohen dy kandidat nga tre sa janë të propozuar: Konstatoj se 12 vota për dje 10 kundër është aprovuar propozimi i z. Rasim Fazliu.

Isak Hoti – Shumica nga anëtarët e kuvendit që janë këtu janë kuvendarë rrafsh qe 15 vite, këto gjëra i caktion rregullorja e punë së kuvendit e jo Isak Hoti, nuk flasë çka është në kundërshtim me ligjin. Rregullorja e punës së kuvendit decidevishtë neni 64 thotë: Kur duhet të zgjidhet ose të emërohet ndonjë anëtar për ndonjë funksion ose pozitë në komunë dhe për këtë ekziston dy ose më shumë propozime, emrat e të propozuarve shënohen në listë, sipas renditjes së alfabetit të mbiemrave të tyre. Votimi bëhet ashtu që në fletëvotim shënohet me shenjën X afér emrit të kandidatit për të cilin kandidati dëshiron të votojë, duke hedhur fletëvotimin në kutinë e caktuar për votim.

Ali Morina – Me këtë rast ne jemi duke e shkelur rregulloren punës së kuvendit komunal të komunës së Rahovecit.

Kryesuesi - Le të dalin anëtarët e komisionit që të përcjellin mbarëvajtjen e votimit. Të nderuar do ju thërrasim me emra një nga një, pastaj do të vini që të merrni fletëvotimin tek z. Skender Hamza, do të votoni në kabinë, dhe pastaj do e futeni në kutin e votimit. Thërras komisionin që të bëjë verifikimin e fletëvotimeve, të shikoj se a janë aq fletëvitime sa janë edhe nënshkrime të kuvendarëve, pastaj të na njoftojnë me rezultatin se kush është zgjedhur anëtar i komisionit ad hoc.

Faton Ramadani- Ju njoftoj me rezultatin, ishin 25 nënshkrime në listë, po ashtu ishin 25 fletëvitime në kuti, 3 prej tyre ishin të pavlefshme. Kandidati me nr.1* z. Munib Durguti i ka marrë 13 vota, kandidati me nr.2 z. Bajram Morina i ka marrë 10 vota dhe kandidati me nr.3 z. Masar Popaj i ka marrë 13 vota.

Kryesuesi – Sipas raportit të komisionit, anëtar të komisionit ad hoc nga radhët e kuvendit janë zgjedhur z. Munib Durguti dhe z. Masar Popaj, kurse nga radhët e fshatit Hoçë e Madhe janë propozuar z. Mlagjan Gërgoviq, z. Radovan Pantiq, dhe z. Bojan Lukiq. E qes në votim komplet listën e komisionit ad hoc të këshillit të fshatit Hoçë e madhe, anëtar të këtij komisioni janë pesë 2 shqiptar nga kuvendi komunal dhe 3 serb nga komuniteti serb nga fshati Hoçë e Madhe, po i ceki edhe një herë të gjithë emrat:z. Munib Durguti, z. Masar Popaj, z. Mlagjan Gërgoviq, z. Radovan Pantiq, dhe z. Bojan Lukiq: Konstatoj se me shumicë votash është aprovuar Komisioni ad hoc përfshirë fshatin Hoçë e Madhe.

Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15:45

Procesmbajtësi

Skender Hamza



KRYESUESI

Afrim Dina